

Thaçi kërkon nga Engeli që ShBA-ja të mbetet e fokusuar në çështjen e Kosovës



FAQE 5

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", DAUT HARADINAJ ■ FAQE 4-5



Koalicioni është stabil, nuk do të ketë zgjedhje këtë vit

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka bërë me dije se nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme këtë vit. Ai ka thënë se koalicioni qeverisës është stabil dhe duhet t'i përfundojë çështjet e hapura me Serbinë. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Haradinaj ka deklaruar se opozita mund ta rrëzojë qeverinë kurdo që t'i ketë numrat. Ai ka vlerësuar se AAK-ja është në situatën më të mirë të mundshme dhe, sipas tij, mobilizimi i strukturave dhe vendimet e qeverisë kanë bërë që kjo parti të ketë mbështetje të madhe popullore. Ai nuk ka dashur ta komentojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për ekipin negociator, por ka thënë se është i nevojshëm bashkimi i brendshëm karshi Serbisë

Veseli kërkon barazi gjinore në të gjitha fushat e jetës

Grupi i Grave Deputete (GGD) ka arritur të funksionojë si një forum përfaqësues përtej dallimeve partiake në funksion të agjendës së barazisë gjinore. Kështu ka deklaruar kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në shënimin e 14-vjetorit të themelimit të GGD-së. Ai ka vlerësuar se ky grup ka justifikuar plotësisht qëllimin për të cilin është krijuar. Veseli ka thënë se duhet të jetësohet barazia gjinore në të gjitha fushat e jetës ■ FAQE 7



Vetëvendosja e quan skandal rekrutimin e noterëve të rinj

FAQE 6

OPINION

RADARI MBI LIRINË E SHPREHJES

F. 11

Faton ISMAJLI



AKTUALE

RRUGA GJAKOVË - TROPOJË MERR EMRIN E KONGRESISTIT ELIOT ENGEL F. 3

KRYEMINISTRI HARADINAJ: KOSOVA, PALË SERIOZE NË ZBATIMIN E ZOTIMEVE TË PROCESIT TË BERLINIT F. 3

EKONOMI

UJËSJELLËSI ZGJAT ORARIN E PUNËS PËR SHKAK TË MËRGIMTARËVE F.8

GRANTET E MINISTRISË SË BUJQËSISË PO GJENEROJNË VENDE TË REJA PUNE F.8



KULTURË

MOTRAT E SHOTËS, VIZITË TE VARRI I SAJ NË FUSHË-KRUJË F. 18



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ischingeri: Evropa s'mund të presë më rreth zgjidhjes së çështjes Kosovë - Serbi



BRUKSEL, 5 KORRIK - Diplomati gjerman Wolfgang Ischinger, ka thënë se dy dekada pas përfundimit të luftës në Kosovë, një zgjidhje politike midis Prishtinës dhe Beogradit mbetet e paarrtshme dhe një situatë frustruese në rajon. Ischingeri që njëherësh është kryetar i Konferencës së Sigurisë së Mynihut, ka thënë se Marrëveshja e Dejtonit është

"shembull i mirë i diplomacisë e cila duhet të zbatohet në dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës". Ai në një tekst autorial të titulluar "Udhërrëfyesi për Ballkanin" të publikuar në "Politiko" me bazë në Bruksel, ka shkruar se Evropa nuk mund të përballojë dot të presë vetë dhe shpreson që problemi të dallojë, sepse, siç thotë ai, "konflikti i

pazgjidhur" në zemër të Evropës paraqet një rrezik të papranueshëm gjeopolitik, sidomos në kohë të trazirave globale. Ai ka thënë se Marrëveshja e Paqes e Dejtonit e vitit 1995, megjithëse e papërsosur si një kornizë politike për një shtet funksional, është një shembull i mirë i llojit të diplomacisë që duhet të zbatohet në dialogun Kosovë - Serbi.

Trumpi lavdëron ushtrinë në ceremoninë e Ditës së Pavarësisë

Gjatë ceremonisë për shënimin e 4 Korrikut, Ditës së Pavarësisë, presidenti Trump tha se ne e festojmë historinë tonë, popullin tonë dhe heronjtë që mbrojnë me krenari flamurin tonë: burrat dhe gratë e guximshëm të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara



UASHINGTON, 5 KORRIK - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, e lavdëroi ushtrinë dhe foli për madhësinë e shtetit amerikan gjatë një ceremonie për shënimin e 4 Korrikut, Ditës së Pavarësisë së ShBA-së. Në fjalimin e tij, Trumpi i tha një turme të mbledhur për ta ndjekur ceremoninë se "kombi ynë është më i fuqishëm se kurrë më parë". Katër Korriku festohet në të gjithë Shtetet e Bashkuara për ta shënuar nënshkrimin e Deklaratës së Pavarësisë së vendit më 1776. Kjo është hera e parë që Shtetet e Bashkuara e kremtojnë Ditën e Pavarësisë me Paradë Ushtarake, por presidenti Trump u frymëzua për të bërë një ceremoni të tillë duke parë një shfaqje të ngjashme në Francë. "Ne e festojmë historinë tonë, popullin tonë dhe heronjtë që mbrojnë me krenari flamurin tonë: burrat dhe gratë e guximshëm të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara", tha Trumpi. "Për më shumë se 65 vjet, asnjë forcë ajrore e armikut nuk ka arritur të vrasë një ushtar të vetëm amerikan. Sepse qiejt i përkasin Shteteve të Bashkuara të Amerikës", tha më tutje në fjal-

imin e tij, presidenti Trump. Përpara fjalimit, demokratët akuzuan presidentin se po bën fushatë nëpërmjet një organizimi të tillë. Demokratët ngritën shqetësime edhe për shpenzimet e organizimit të ceremonisë, të cilat ishin paraparë të përballoheshin prej fondeve të Departamentit Kombëtar të Parqeve. Senatori Bernie Sanders, një

kandidat demokrat për president, kritikoi organizimin e Trumpit. "Kjo është ajo që autoritarët bëjnë. Donald Trumpi po merr 2.5 milionë dol-

larë nga Shërbimi Kombëtar i Parqeve për të lavdëruar veten me një spektakël të tankeve ushtarake që rrotullohen nëpër Uashington", shkroi ai në një

postim në "Twitter".

"Donald Trump, besoj, është i paafte për të festuar atë që e bën Amerikën e madhe. Kjo është hera e parë që SHBA-ja nxjerr ushtrinë në rrugë për të festuar Ditën e Pavarësisë", tha ish-nën-presidenti Joe Biden, i cili është duke udhëhequr në sondazhet e opinionit në garën për nominimin presidencial demokratik të vitit 2020, në Iowa.

Presidenti i fundit që fliste në një ceremoni të shënimin të 4 Korrikut, në Uashington, ishte shtatë dekada më parë kur Harry Truman iu drejtua një turme pranë Monumentit të Uashingtonit, për të shënuar 175-vjetorin e nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë.

Çitaku feston Pavarësinë e ShBA-së me sekretarin Pompeo

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka publikuar fotografi nga festa ku ajo mori pjesë për shënimin e 243 vjetorit të Pavarësisë së ShBA-së. Në një publikim në rrjetin social "Facebook" ajo ka shpërndarë një fotografi me sekretarin e shtetit, Mike Pompeo dhe zonjën Pompeo, me mesazhin për urimin e përvjetorit të Pavarësisë. "Bashkë me

Sekretarin e Shtetit Mike Pompeo dhe zonjën Pompeo duke festuar 243-vjetorin e Pavarësisë së ShBA-së. Kosova është e bekuar me mbështetjen amerikane", ka shkruar Çitaku në "Facebook". Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë shënuar dje 243 vjetorin e Pavarësisë së tyre. Në Kosovë, kjo ngjarje u shënuar me përvjetorin e objektit të ri gjigant të Ambasadës amerikane në Prishtinë.



Basha: Asnjë hap pas për largimin e Ramës, të hënën protestë



TIRANË, 5 KORRIK - Opozita ngul këmbë se ishte vetëm 15 % pjesëmarrja në votimet moniste të 30 qershorit, pavarësisht shifrave të bëra publike nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Duke theksuar se 85 % e shqiptarëve refuzuan Edi Ramën, kreu i PD-së, Lulzim

Basha përmes një postimi në facebook u bën thirrje të gjithëve që t'i bashkohen protestës së 8 korrikut, në orën 20:00, për të kërkuar largimin e Edi Ramës. "Me 30 qershor 85 % e shqiptarëve refuzuan dhunimin e Kushtetutës. 85 % e shqiptarëve refuzuan farsën e

votimeve moniste, 85 % e shqiptarëve refuzuan politikën e bërë njësh me krimin. 85 % e shqiptarëve refuzuan politikën e varfërisë dhe mjerimit. 85 % e shqiptarëve refuzuan vjedhjen me ligj, me PPP, me koncesione dhe oligarkë. 85 % e shqiptarëve refuzuan Edi Ramën! Të

hënën, më 8korrik në orën 20:00 bashkohemi të gjithë në Tiranë kundër diktaturës, bashkohemi në mbrojtje të lirisë dhe pluralizmit, bashkohemi për familjet dhe fëmijët tuaj, për Shqipëria si Evropa! Asnjë hap pas! Rama ik", ka shkruar Basha.

Përfundon samiti i vendeve të Ballkanit Perëndimor që është mbajtur në Poznan të Polonisë

Haradinaj: Kosova, palë serioze në zbatimin e zotimeve të procesit të Berlinit

Në ditën e fundit të samitit të Poznanit, në të cilin liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë takuar me homologët e tyre nga vendet e BE-së, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova është palë serioze për zbatimin e zotimeve të procesit të Berlinit. Në këtë samit dyditorë ai ka bërë me dije se Kosova është zotuar për procesin e Berlinit dhe është angazhuar për të arriturat e këtij procesi në vazhdimësi



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka konfirmuar pozicionin e Kosovës dhe marrjen e angazhimeve në proceset rajonale.

Në samitin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, i cili është mbajtur në Poznan të Polonisë, ai ka thënë se Kosova është zotuar për procesin e Berlinit dhe është angazhuar për të arriturat e këtij procesi në vazhdimësi. Në sesionin plenar, ku është diskutuar për rritjen ekonomike, reformat e nevojshme që nxisin sipërmarrjen, inovacionin dhe konkurrueshmërinë në Ballkanin Perëndimor, Haradinaj ka thënë se zotimet që dalin nga samiti i Poznanit, Kosova si palë serioze i merr me përgjegjësi të plotë për zbatimin e tyre.

Duke folur rreth procesit të finalizimit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, kryeministri ka treguar se ka dallime të mëdha ndërmjet dy vendeve që munden dhe duhet të zgjidhen. "Unë dua të shoh rritje të tregtisë, pa barriera, midis dy vendeve tona. Por kjo nuk është një çështje e thjeshtë, ekziston një kontekst më i gjerë politik ku duhet të merren vendime të guximshme. Është e domosdoshme Marrëveshja Kornizë e Përbashkët mbi Dialogun mbi Njohjen e Ndërsjellë në kufijtë ekzistues midis dy shteteve tona", ka thënë Haradinaj, duke e vlerësuar se kjo është rruga e vetme përpara dhe Kosova mbetet e përkushtuar

për arritjen e këtij qëllimi. Në këtë sesion të pranishëm kanë qenë edhe kryeministri i Polonisë, Mateusz Morawiecki, kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, kryeministrja e Mbretërisë së Bashkuar, Theresa May, përfaqësuesja e lartë e BE-së për Politikë të Jashtme, Federica Mogherini, kryeministrat dhe ministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor, sekretarja e përgjithshme e RCC, Majlinda Bregu, përfaqësues të shteteve, organizatave, si dhe përfaqësues të BERZh-it, OECD-së dhe RYCO-s.

Mbështetet procesi i pranimit të Ballkanit Perëndimor në BE

Zyrtarët e lartë të vendeve anëtare Bashkimit Evropian kanë siguruar vendet e Ballkanit Perëndimor, që synojnë t'i bashkohen BE-së, se blloku ende qëndron pozitiv për aspiratat e tyre.

Në samitin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Poznan, ministri gjerman për Evropën, Michael Roth, ka thënë se Berlinit mbështet procesin e pranimit të gjashtë vendeve të rajonit. "Të gjithë jemi përgjegjës për të siguruar që perspektiva e pranimit në BE mbetet konkrete", ka thënë ai.

Roth ka bërë thirrje për një hapje të shpejtë të bisedimeve të vonuara të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.

Në hapjen e samitit dyditorë ministri i Jashtëm polak Jacek

Czaputowicz ka bërë thirrje për bashkëpunim më të fortë midis BE-së dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke thënë se kjo do të ndihmojë në rritjen e stabilitetit dhe zhvillimit të

rajonit. Muajin e kaluar shtetet anëtare të BE-së kanë shtyrë një vendim për hapjen e negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë deri në tetor. Disa anëtarë të bllokut,

duke përfshirë Francën dhe Holandën, ishin kundër hapjes së negociatave. Katër vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, që kërkojnë të anëtarësohen në BE, janë Bosnjë Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova.

Polonia kritikon BE-në për rastin e Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut

Presidenti i Polonisë, Andrzej Duda, ka kritikuar Bashkimin Evropian për shtyrjen e bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, duke i bërë thirrje bllokut që t'ua ofrojë vendeve të Ballkanit një rrugë të drejtë anëtarësimit në BE. Ai ka thënë se shteteve të Ballkanit nuk duhet t'u kërkohej të marrin pjesë në një garë ku nuk mund ta shohin vijën e fundit të finales. "Ballkani është pikë së pari një pjesë

integrale e Evropës si gjeografikisht ashtu edhe kulturisht dhe historikisht. Pa integrimin e plotë të Ballkanit, së bashku me traditat e tyre të bukura dhe kulturën e larmishme, Evropa nuk do të jetë në gjendje kurrë të marrë frymë thellë. I them këto fjalë me ndërgjegjen e të qenit president i një vendi që ka përfitur shumë nga resurset zhvillimore të Bashkimit Evropian, me dijeninë që këto resurse duhet të

përdoren në të ardhmen edhe për të tjerët", ka thënë ai, duke shtuar se vendi i tij mbështet zgjerimin e BE-së. "Theksoj se Polonia është një vend që mbështet politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian, sepse mbështet Evropën e hapjes dhe solidaritetit, jo Evropën e paragjykitimeve të ndërsjella, e të mbylljes nga interesa dhe frika të veçanta. Nuk është kjo Evropa që duam", ka thënë presidenti polak në fjalën e tij në samitin e Poznanit.



Rruga Gjakovë - Tropojë merr emrin e kongresistit Eliot Engel

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Rruga nacionale Gjakovë - Tropojë ka marrë emrin e kongresistit amerikan dhe mikut të shqiptarëve, Eliot Engel.

Në Qafë Morinë, kufirin në mes të Gjakovës dhe Tropojës, ku ishte i pranishëm Eliot Engeli, presidenti Ilir Meta, përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari, kryetari i

Gjakovës, Ardian Gjini dhe ai i Tropojës, Besnik Dushaj, është mbajtur ceremonia me rastin e emërtimit të kësaj rruge.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se emri i Eliot Engelit është i gdhendur në zemrat e të gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen. Ndërsa kongresisti amerikan Eliot Engel ka thënë se për të

është kënaqësi të shohë kur emërohet diçka me emrin e tij. Ai ka theksuar se miqësia në mes të popullit amerikan dhe shqiptarëve do të jetë e përgjeshme.

Kongresisti Engel ka thënë se ShBA-ja, Shqipëria dhe Kosova si aleatë qëndrojnë përkrahë lirisë dhe demokracisë.

Flet për "Epokën e re", Daut Haradinaj

Koalicioni është stabil, nuk



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka bërë me dije se nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme këtë vit. Ai ka thënë se koalicioni qeverisës është stabil dhe duhet t'i përfundojë çështjet e hapura me Serbinë. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" Haradinaj ka deklaruar se opozita mund ta rrëzojë qeverinë kurdo që t'i ketë numrat. Ai ka vlerësuar se AAK-ja është në situatën më të mirë të mundshme dhe, sipas tij, mobilizimi i strukturave dhe vendimet e qeverisë kanë bërë që kjo parti të ketë mbështetje të madhe popullore. Ai nuk ka dashur ta komentojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për ekipin negociator, por ka thënë se është i nevojshëm uniteti i brendshëm karshi Serbisë

duke u trajtuar në formën më të mirë të mundshme", ka theksuar ai.

Haradinaj ka thënë se ky koalicion duhet t'i përfundojë çështjet e hapura me Serbinë dhe, sipas tij, këtë vit nuk do të ketë zgjedhje. Por kurdo që mbahen ato, Haradinaj ka thënë se AAK-ja gëzon mbështetje popullore dhe do të dalë fituese. "Ne jemi tepër të interesuar që ky koalicion t'i përmbyllë disa tema që janë tash e sa kohë të hapura me Serbinë. Zgjedhje nuk do të ketë këtë vit, pasi pothuajse të gjithë e dinë se AAK-ja është në situatën më të mirë të mundshme. Mobilizimi i strukturave dhe vendimet e mëdha të Qeverisë kanë bërë që të kemi mbështetje të madhe popullore. Zgjedhjet do t'i fitojë AAK-ja. Kjo tashmë është e sigurt. Edhe

sondazhet e fundit po na qesin afër të parit", ka theksuar Haradinaj.

Ai nuk ka dashur ta komentojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese e cila e ka shpallur jokushtetues Ligjin për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë, por ka thënë se është i nevojshëm uniteti i brendshëm karshi Serbisë. "Nuk është në mandatin tim ta komentojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por ajo që është me rëndësi për neve është uniteti i brendshëm karshi Serbisë", ka deklaruar Haradinaj.

Duke folur për inskenimin e krizës humanitare në veri, ai ka thënë se kjo është një përpjekje e kotë e Serbisë. Haradinaj ka vlerësuar se

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 5 KORRIK - Deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Daut Haradinaj, ka thënë të premten se koalicioni qeverisës është stabil dhe nuk ka asnjë temë të hapur në mes të liderëve të tij. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", ai ka deklaruar se kurdo që t'i sigurojë votat opozita mund ta rrëzojë qeverinë. "Përderisa ne nuk kemi as një temë të hapur brenda partnerëve të koalicionit unë e konsideroj këtë koalicion stabil. Jemi këtu dhe në çdo situatë që opozita i bënë numrat le të veprojnë", është shprehur Haradinaj, duke

shtuar se bojkoti nuk është gjë tjetër veçse një formë kundërshtimi nga opozita. "E rëndësishme është që një pjesë e madhe e ligjeve kanë gjetur mbështetjen e shumicës së deputetëve. Bojkoti opozitar nuk është gjë tjetër veçse një formë kundërshtimi nga opozita pasi temat nacionale pothuajse janë

do të ketë zgjedhje këtë vit

opozitës?

Daut Haradinaj: E rëndësishme është që një pjesë e madhe e ligjeve kanë gjetur mbështetjen e shumicës së deputetëve. Bojkoti opozitar nuk është gjë tjetër veçse një formë kundërshtimi nga opozita, pasi temat kombëtare pothuajse janë duke u trajtuar në formën më të mirë të mundshme.

"Epoka e re": Cili është bashkëpunimi aktual mes partnerëve të koalicionit qeverisës?

Daut Haradinaj: Përderisa ne nuk kemi as një temë të hapur brenda partnerëve të koalicionit unë e konsideroj këtë koalicion stabil.

"Epoka e re": Opozita të martën ka paralajmëruar se së shpejti do ta ngrëhë mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë Haradinaj. Mendoni se opozita mund t'i sigurojë edhe tri vota për t'u arritur synimi i saj, rrëzimi i qeverisë?

Daut Haradinaj: Kurdo që opozita t'i bëjë numrat le të veprojë.

"Epoka e re": A është AAK-ja e gatshme për zgjedhje të parakohshme, sepse ka pasur deklarime nga bashkëpartiake tuaj se AAK-ja qëndron mirë me sondazhe. Në çfarë pozicioni politik e shihini këtë parti në rast se zgjedhjet mbahen këtë vjeshtë?

Daut Haradinaj: Ne jemi tepër të interesuar që ky koalicion t'i përmbyllë disa tema që janë tash e sa kohë të hapura me Serbinë. Zgjedhje nuk do të ketë këtë vit, pasi pothuajse të gjithë e dinë se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është në situatën më të mirë të mundshme. Mobilizimi i strukturave dhe vendimet e mëdha të qeverisë kanë bërë që të kemi mbështetje të madhe popullore. Zgjedhjet do t'i fitojë AAK-ja dhe kjo tashmë është e sigurt. Edhe sondazhet e fundit po na qesin afër të parit.

"Epoka e re": Javën e kaluar Gjykata Kushtetuese ka shpallur jokushtetues Ligjin për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë. Si e shihni vazhdimin e procesit të dialogut pas këtij vendimi dhe a ka qenë gabim refuzimi i kryeministrit Haradinaj që mos të merret ai personalisht

me dialogun?

Daut Haradinaj: Nuk është në mandatin tim ta komentoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por ajo që është me rëndësi për ne është uniteti i brendshëm karshi Serbisë.

"Epoka e re": Së fundmi në veri Serbia po tenton të inskenojë një krizë humanitare atje. Ka rrezik të keqësimit të situatës në këtë pjesë?

Daut Haradinaj: Janë tendenca të kota të politikës serbe.

Kosova është shtet stabil dhe ka kapacitete të plota për ta siguruar stabilitetin e territorit të vet. Politika fashiste e Beogradit po dekonspirohet për ditë. Beogradi po i keqpërdor serbët e Kosovës.

PRESIDENTI HASHIM THAÇI KA PRITUR NË TAKIM KRYESUESIN E KOMISIONIT PËR PUNË TË JASHTME NË KONGRESIN AMERIKAN, KONGRESISTIN ELIOT ENGEL

Thaçi kërkon nga Engeli që ShBA-ja të mbetet e fokusuar në çështjen e Kosovës

Presidenti Hashim Thaçi ka kërkuar nga kongresisti amerikan Eliot Engel të angazhohet që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mbeten të fokusuar në çështjen e Kosovës deri në konsolidimin e plotë ndërkombëtar të saj. Thaçi e ka falënderuar kongresistin amerikan për përkrahjen e vazhdueshme që e ka dhënë për Kosovën

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 KORRIK - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të premten ka pritur në takim kryesuesin e Komisionit për Punë të Jashtme në Kongresin Amerikan, kongresistin Eliot Engel, i shoqëruar nga zonja Engel dhe bashkëpunëtorët, të cilin e ka falënderuar për përkrahjen e vazhdueshme për Kosovën. "Ju jam mirënjohës për angazhimin tuaj personal prej dekadash për Kosovën dhe popullin shqiptar në përgjithësi", është shprehur presidenti Thaçi.

Presidenti Thaçi ka shprehur kënaqësinë para kongresistit Engel dhe ambasadorit Kosnett për përrurimin e ndërtesës së re të Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë, duke krahasuar momentin e 4 Korrikut 2019 me hapjen e Zyrës Amerikane në Kosovë në vitin 1996. "Është impulsive kur e kujtojmë se ku ishim në vitin '96 dhe kur shohim ku jemi sot. Për këtë i jemi mirënjohës përkrahjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të gjithë miqve që na kanë përkrahur gjithë këto vite", ka theksuar Thaçi. Presidenti Thaçi e ka ftuar kongresistin Engel të angazhohet

që ShBA-ja të mbetet e fokusuar në çështjen e Kosovës deri në përmblylljen e plotë të stories së Kosovës me konsolidimin e plotë ndërkombëtar të vendit. Ndërsa kongresisti Eliot Engel ka thënë se është i gëzuar që është përsëri në Kosovë, veçanërisht për të qenë pjesë e shënimit të 4 korrikut me inaugurimin e objektit të ri të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Engeli ka vlerësuar progresin e madh që Kosova ka bërë në vitet që nga pavarësia si dhe ka shprehur optimizëm se vendi ynë do të vazhdojë të përparojë drejt demokracisë dhe sundimit të ligjit.



Kosova është shtet stabil dhe ka kapacitete të plota për ta siguruar stabilitetin e territorit të vet. "Janë tendenca të kota të politikës serbe. Kosova është shtet stabil dhe ka kapacitete të plota për ta siguruar stabilitetin e territorit të vet. Politika fashiste e Beogradit po dekonspirohet për ditë. Beogradi po i keqpërdor serbët e Kosovës", është shprehur Haradinaj.

"Epoka e re": Z. Haradinaj, po bëhen dy vjet prej kur deputetët kanë dhënë betimin për këtë legjislaturë. Sa jeni kënaqur me punën e këtij Kuvendi kur kemi parasysh se shumë seanca në mungesë të kuorumit nuk janë mbajtur. Rasti i fundit ishte edhe me bojkotimin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit nga anëtarët e

Vetëvendosja e quan skandal rekrutimin e noterëve të rinj

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosje e kanë vlerësuar si skandal procesin e rekrutimit të noterëve të rinj. Deputetet e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu dhe Fitore Pacolli, kanë folur për shpërputhjen e plotë mes deklaratave të kësaj qeverie se synojnë liberalizimin e vizave, ndërkohë që në praktikë veprojnë në drejtim të kundërt me kriteret.

Deputetja e këtij subjekti politik, Albulena Haxhiu, ka deklaruar se edhe pse po thuhet se kriteret për liberalizimin e vizave janë përmbushur, kriteret më të rëndësishme nuk po dëshmojnë se po luftohen krimi i organizuar, keqpërdorimet dhe korrupsioni. "Ministria e Drejtësisë, në vend se të japë kontribut në rastet e shënjestruara për liberalizimin e vizave në këtë drejtim, i del në shesh skandali i rekrutimit të noterëve të rinj", ka thënë Haxhiu të premten në një konferencë për medie. Sipas

saj, tek tani po kuptohet se pse ministri i Drejtësisë vazhdimisht tregonte për shtimin e numrit të noterëve. "Qartë po shihet pse Tahirit i ka interesuar rritja e numrit të noterëve të rinj. Tani ka dalë lista dhe jemi të vetëdijshëm që në mesin e tyre ka të tillë që e kanë kaluar testin në bazë të profesionalizmit, por ne mendojmë se ky proces ka qëllim dhënien e licencës për noterë dhe njerëzve të tyre duke vazhduar me kapjen e shtetit", ka deklaruar Haxhiu.

Kurse deputetja tjetër e LV-së, Fitore Pacolli, ka vlerësuar se shtetet anëtare të BE-së po hezitojnë ta mbështesin Kosovën për liberalizim të vizave, pikërisht për shkak të korrupsionit në vend. "Qytetarët e Republikës së Kosovës e meritojnë liberalizimin e vizave, por kjo do të ndodhë vetëm kur Kosova lufton korrupsionin dhe krimin e organizuar", ka deklaruar Pacolli.



Ndërkaq ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i ka vlerësuar të papranueshme deklaratat e

Lëvizjes Vetëvendosje që, sipas tij, kanë tendencë të komprometojnë çdo proces në vend,

përfshirë edhe provimin e noterisë i cili është tërësisht profesional dhe apolitik.

Universiteti 'Kadri Zeka' hap konkurs për pranimin e studentëve të rinj



Universiteti "Kadri Zeka" në Gjirokastrë në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2018/2019, do t'i regjistrojë 925 studentë të rregullt në studime bachelor. Nga numri i përgjithshëm i përcaktuar, universiteti do të regjistrojë deri në 12 për qind studentë të rregullt nga komuniteti joshumicë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

GJILAN, 5 KORRIK - Universiteti "Kadri Zeka" në Gjirokastrë ka hapur konkursin për pranimin e studentëve të rinj, në vitin e parë të studimeve bachelor, për vitin akademik 2019/2020.

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjirokastrë në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2018/2019, do t'i regjistrojë 925 studentë të rregullt në studime bachelor. Nga numri i përgjithshëm i përcaktuar, universiteti do t'i regjistrojë deri në 12 për qind studentë të rregullt nga komuniteti joshumicë.

Po ashtu, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i mund

të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, Shqipëria dhe Maqedonia 2 për qind e kandidatëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.

Kurse 1 për qind e kandidatëve nga Mali i Zi.

Po ashtu, në bazë të kuotave mund të pranohen edhe 2 për qind e kandidatëve nga Shqipëria dhe Maqedonia, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.

Të drejtë pranimi në Universitetin "Kadri Zeka" kanë të gjithë kandidatët kosovarë të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve afatet e konkursit janë si vijon: Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 05.07.2019 deri më 15.07.2019 nga ora 9:00 deri në orën 16:00. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse si dhe në uebfaqet e universitetit. Provimi pranues do të mbahet më 18.07.2019.

Hollësitë lidhur me kohën e mbajtjes së provimit pranues sipas njësive akademike do të shpallen në uebfaqen e universitetit më 17.07.2019. Shpallja e rezultateve të provimit pranues do të bëhet më së voni deri më 22.07.2019 në fakultetet përkatëse si dhe në uebfaqen e universitetit.

Një delegacion nga Kuvendi i Maqedonisë Veriore viziton më 8 korrik Kosovën

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, do të jetë mikpritës i delegacionit të komisionit homolog nga Kuvendi i Republikës së

Maqedonisë Veriore, më 8 korrik, duke filluar nga ora 10:00. Delegacioni nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë Veriore do të kryesohet nga Fadil Zendeli, kryetar i komisionit. Temë e takimeve ndërmjet parla-

mentarëve të të dyja vendeve, do të jenë çështjet aktuale të të drejtave të njeriut, të barazisë gjinore, të drejtat e bashkësive nacionale si dhe këmbimi i praktikave më të mira nga fushat e lartpërmendura.



Është shënuar 14-vjetori i themelimit të Grupit të Grave Deputete (GGD)

Veseli kërkon barazi gjinore në të gjitha segmentet e jetës

Grupi i Grave Deputete (GGD) ka arritur të funksionojë si një forum përfaqësues përtej dallimeve partiake në funksion të agjendës së barazisë gjinore. Kështu ka deklaruar kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në shënimin e 14-vjetorit të themelimit të GGD-së. Ai ka vlerësuar se ky grup ka justifikuar plotësisht qëllimin për të cilin është krijuar. Veseli ka thënë se duhet të jetësohet barazia gjinore në të gjitha segmentet e jetës

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 5 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka marrë pjesë të premtën në ceremoninë e shënimit të 14-vjetorit të themelimit të Grupit të Grave Deputete (GGD), ku ka kërkuar të jetësohet barazia gjinore në të gjitha segmentet e jetës. Ai ka thënë se zhvillimi i një shoqërie arrihet vetëm kur aktivizohet i gjithë potenciali i grave.

Kryeparlamentari Veseli ka vlerësuar se GGD-ja është grupi më i veçantë në të gjitha legjislaturat e këtij Kuvendi, i cili, sipas tij, gjatë gjithë ekzistencës e ka justifikuar plotësisht qëllimin për të cilin është krijuar. Ai ka deklaruar se ky grup ka arritur të funksionojë si një forum përfaqësues përtej dallimeve partiake në funksion të një agjende nacionale siç është agjenda e barazisë gjinore dhe mbështetja e grupeve të marginalizuara të shoqërisë. "Unë sot jam këtu para jush që t'ju përgëzoj për frymën shumë pozitive të bashkëpunimit që keni ndërtuar dhe sukseset që keni arritur në fushat e angazhimit tuaj. Njëkohësisht t'ju siguroj se do ta keni përkrahjen time të

pakursyer që ju të vazhdoni edhe më tutje, ta fuqizoni grupin dhe t'i zgjeroni angazhimet e tij", ka theksuar Veseli. Ai ka thënë se Kosova ka ecur shumë në këtë drejtim, kur është fjala të legjislacioni por, sipas Veselit, ende ka shumë punë për të bërë që ky legjislacion të zbatohet në mënyrë rigoroze. Ai ka theksuar se barrierat e mentaliteteve të vjetra që ushqejnë paragjykimet diskriminuese dhe praktikën e përjashtimit të grave nga jeta sociale dhe institucionale ende janë duke rezistuar, megjithëse forca e tyre nga dita në ditë po

vjen duke u zbehur. Duke përmendur kontributin e grave deputete në këtë rast, kryetari i Kuvendit kujtoi se vetëm në vitin e fundit ato kanë arritur të trajtojnë disa prej ligjeve të rëndësishme. Përkundër arritjeve, kryeparlamentari Veseli ka thënë se sfidat si shtet dhe shoqëri ende janë të mëdha në radhë të parë ato të zhvillimit ekonomik. "Puna është ajo që i jep kuptim jetës njerëzore në shoqërinë bashkëkohore, prandaj obligimi ynë më i madh, detyra më e madhe patriotike në ditët e sotme, është që të bëjmë

të mundur një shoqëri të shanseve për të gjithë qytetarët e Kosovës, një shoqëri ku mund të ketë punë për të gjithë, sidomos për të rinjtë tanë. Që të ecim në këtë drejtim është e nevojshme t'i lëmë debatet shterpe dhe ta kthejmë politikën te qytetari, te problemet e përditshmërisë së tij jetësore. Vetëm duke e bërë këtë merr kuptim roli ynë si përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve. I potencova këto mesazhe sepse ju jeni një nga forumet më adekuate për një gjë të tillë", është shprehur kryeparlamentari Veseli.



Rreth 400 gra dhe 12 burra me statusin e viktimës së dhunës seksuale

PRISHTINË, 5 KORRIK - Më shumë se 1 050 persona kanë dorëzuar aplikacionet për verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998-1999). Aplikimet kanë filluar të paraqiten që nga muaji shkurt i vitit të kaluar, kur edhe ka filluar zbatimi i ligjit përkatës për këtë kategori.

Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës thonë se nga numri i përgjithshëm i atyre që kanë aplikuar për statusin e viktimës së dhunës seksuale, deri më tani janë trajtuar 598 raste, kurse 406 viktima, nga to 394 femra dhe 12 meshkuj, tashmë kanë pranuar përfitimet e njohura me ligj. Përdhunimet, konsiderohen ndër krimet më të tmerrshme që njeh njerëzimi dhe të cilat, si në shumë vende të botës ku kishte apo ka luftëra e konflikte, ndodhën edhe në Kosovë gjatë

konfliktit të viteve 1998-'99.

Bazuar në deklaratat e zyrtarëve të institucioneve të Kosovës, gjatë luftës së fundit kanë ndodhur rreth 20 mijë raste të abuzimit seksual.

Për ta lehtësuar sadopak gjendjen e kësaj kategorie në vitin 2014, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar ndryshimet e nevojshme ligjore në mënyrë që personave që përjetuan këto krime gjatë luftës t'u njihet statusi i viktimës së dhunës seksuale, me çka u është mundësuar ta marrin pensionin ligjor që arrin në vlerën prej 230 eurosh në muaj.

Minire Begaj-Balaj, kryetare e komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë, në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë" thotë se deri në fund të muajit qershor, nga



numri i përgjithshëm i aplikimeve që arrin shifrën prej 1 057 sish, statusi u është pranuar 406 vetave, në pritje për trajtim janë edhe 459 raste, janë refuzuar 152 aplikacione dhe në proces janë 55 raste. Ajo tregon se afati përfundimtar për ta parashtruar kërkesën për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimës

së dhunës seksuale, është pesë (5) vjet nga fillimi dhe zyrtarizmi i punës së Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës. Ky komision ka filluar punën zyrtarisht në shkurt të vitit 2018.

Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës

vazhdimisht ka ndihmuar në procesin e aplikimit të viktimave të dhunës seksuale. Feride Rushiti, drejtoreshë ekzekutive e kësaj qendre, konsideron se, krahasuar me numrin e përgjithshëm të viktimave, numri i aplikimeve është jashtëzakonisht i vogël.

Në muajin prill Bordi Drejtues i Grave të Kosovës ka dorëzuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara peticionin e qytetarëve të Kosovës përmes të cilit kërkohet drejtësi ndërkombëtare. Ky peticion ishte nënshkruar në vitin 2014, nga më shumë se 110 mijë qytetarë në gjithë territorin e Kosovës, përjashtuar komunat e banuara me shumicë serbe. Synimi i këtij peticioni ka qenë dhe mbetet që, siç thuhet, "kryesit e krimeve gjenocidale në Kosovë" të dalin para organeve të drejtësisë.



Grantet e Ministrisë së Bujqësisë po hapin vende të reja pune

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), përmes investimeve me grante investive, po arrin t'i rrisë kapacitetet prodhuese dhe përpunuese në agrobizneset vendore si dhe po krijon vende të reja të punës. Kështu është shprehur sekretari i MBPZHR-së, Kapllan Halimi, në ceremoninë zyrtare

të nënshkrimit të granteve investive me disa përfitues për sektorin e pemëve të imta. Me këtë rast, ai ka treguar se përmes investimeve të ministrisë agrobizneset vendore po arrijnë t'i zgjerojnë veprimtaritë e tyre bujqësore e bashkë me këtë po sjellin edhe prodhime cilësore në tregun vendor si dhe po gjenerojnë vende të reja të punës. "Ministria e Bujqësisë nga viti në vit ka rritur investimet në zhvillimin e

veprimtarive bujqësore në agrobizneset vendore, duke ndikuar kështu në rritjen e prodhimtarisë dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore. Edhe këtë vit ashtu si edhe në vitet e kaluara do t'i vazhdojmë këto investime, me qëllim që sektorin e bujqësisë ta bëjmë sa më konkurrues në tregun e huaj", ka thënë Halimi. Po ashtu, ai ka vlerësuar bashkëpunimin e madh me USAID-in ndër vite në projekte të ndryshme bujqësore.

Ndërsa drejtori i Zyrës për Zhvillim Ekonomik në USAID, Brian Martalus, ka thënë se grantet investive për sektorin e bujqësisë kanë ndikuar që ky sektor të zhvillohet dhe avancohet, bashkë me këtë kjo mbështetje ka rezultuar në qëndrueshmërinë e këtij sektori. Ai ka thënë se bashkëpunimi me MBPZHR-në në projektet bujqësore po sjell rezultate mjaft të mira në avancimin e mëtejshëm të sektorit në gjithë vendin.

Të premtën janë nënshkruar grantet investive me agrobizneset "Laberion", "Joni-Sh" dhe "Manda", të cilat janë përfituese të granteve investive për sektorin e pemëve të imta në kuadër të projektit të MBPZHR-së dhe Misionit të USAID-it, të nënshkruar vitin e kaluar, ku është krijuar një program i veçantë për mbështetjen e zinxhirit të vlerave të frutave të imëta dhe bimëve mjekësore dhe aromatike në Kosovë.

Ujësjiellësi zgjat orarin e punës për shkak të mërgimtarëve



PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" ka njoftuar qytetarët se duke filluar nga 8 korriku deri më 31 gusht ka zgjatur orarin e punës në pikat e shitjes edhe për dy orë të tjera (Zyra për Konsumatorë në Drejtorinë e Ujësjiellësit, pika e shitjes në lagjen "Ulpiana" dhe pika e shitjes te Komuna e vjetër e

Prishtinës). Sipas KRU "Prishtina", arsyeja e zgjatjes së orarit është ardhja e mërgimtarëve në Kosovë. "Jemi duke e shqyrtuar mundësinë që një gjë të tillë ta bëjmë edhe nëpër njësitë e tjera operative. Kështu, orari i punës në këtë departament do të jetë nga ora 08:00-18:00 (gjithsej 10 orë), derisa ditën e shtunë do të punohet nga ora

09:00-16:00 (gjithsej 7 orë). Pra, arsyeja e zgjatjes së orarit janë bashkatdhetarët tanë, pa i përjashtuar konsumatorët e tjerë të KRU 'Prishtina' sh. a., që t'u krijojmë lehtësira për kryerjen e obligimeve që kanë ndaj shërbimeve të ujësjiellësit dhe kanalizimit, gjatë qëndrimit në atdheun e tyre", është thënë në njoftimin e KRU "Prishtina".

Aktakuzë ndaj 19 personave për kontrabandë dhe shmangie të tatimit

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) të premtën ka ngritur aktakuzë kundër nëntëmbëdhjetë (19) personave të cilët, duke vepruar si grup i organizuar kriminal, kanë kryer veprat penale "Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal", "Shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme

doganore" dhe "Shmangia nga tatimi". Sipas aktakuzës, të pandehurit, si grup i organizuar dhe strukturuar kriminal, me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, në vazhdimësi kanë kontrabanduar mallra nga Republika e Maqedonisë përmes rrugëve malore, në vende të ndryshme të Republikës së Kosovës, me

ç'rast, gjatë transportimit të mallrave, kanë përdorur vetura të ndryshme si mjete përcjellëse për sigurimin e rrugëve që shfrytëzonin gjatë kontrabandimit, ku në këtë mënyrë e kanë dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës, përkatësisht Doganat dhe Administratën Tatimore të Kosovës, në shumë rreth 350,000.00 euro.



Monopoli dhe favorizimet ngufasin ekonominë e tregut të lirë

PRISHTINË, 5 KORRIK - Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës garantojnë, të paktën në letër, ekonominë e tregut të lirë dhe konkurrencës së barabartë por, në praktikë, ky model nuk zbatohet në tërësi, thonë përfaqësues të komunitetit të biznesit. Sipas tyre, vetë Qeveria e Kosovës në një mënyrë po krijon monopol dhe favorizime për kompani të caktuara publike dhe private. Nuk është vetëm homologimi i veturave që ditët e fundit është bërë temë debati në institucione dhe shoqëri pasi, sipas tyre, fuqinë në treg e bartin kompanitë private që janë të lidhura me pushtetin në nivel qendror dhe lokal, por edhe me partitë politike. Tenderët publikë, sipas tyre, kanë fuqizuar veprimtarinë e këtyre kom-

panive.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se monopolet shtetërore janë më problematike. Kurse në aspektin tjetër, shprehet Rukiqi, favorizimet e pabarabarta që iu bëhen kompanive të caktuara nga institucionet krijojnë konkurrueshmëri jo të drejtë në treg. "Qasja e pabarabartë nuk lidhet vetëm me ndonjë licencë apo diçka të ngjashme, por qasja e pabarabartë lidhet edhe me mënyrën se si i trajtojnë, nga aspekti i mbledhjes së taksave, nga aspekti i inspektiveve e aspekte të ndryshme, që më pas krijojnë pabarazi në treg", thotë Rukiqi.

Edhe drejtori ekzekutiv i Odës

Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se, përveç praktikës së monopolit për homologim, Oda Amerikane ka shprehur shqetësim për favorizim të ndërmarrjeve të caktuara publike. Ai përmend si rast kur Qeveria e Kosovës e bën blerjen e shërbimeve nga operatorët e telefonisë, pa iu nënshtruar procedurave për prokurim. Praktika të tilla të favorizimit të bizneseve nga Qeveria e Kosovës ndodhin edhe në sektorin privat, thotë Zeka, duke shtuar se kjo dëmton ambientin e rregullt afarist. "Është theksuar edhe nga Oda Amerikane, por edhe në raportet e organizatave ndërkombëtare, se ndërmarrjet

private që kanë lidhje me partitë politike favorizohen qoftë në procedurat e prokurimit, qoftë në forma të tjera. Derisa këto të ndodhin apo derisa Kosova nuk është në gjendje të ofrojë një mjedis të barabartë për të gjitha ndërmarrjet private dhe publike, realisht nuk mund të pritët në tërheqjen e investimeve të huaja direkte", ka thënë Zeka.

Ditët e fundit për çështjen e monopolit të tregut të veturave kanë reaguuar edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Philip Kosnett dhe shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova. Ata i kanë bërë thirrje Qeverisë të veprojë shpejt për zbatimin e rezolutës së Kuvendit të Kosovës për eli-

minimin e rasteve të monopolit në treg, siç është rasti me homologimin e veturave.

Më 2017 edhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kishte konstatuar shkelje ligjore në fushën e homologimit dhe i kishte rekomanduar Ministrisë së Infrastrukturës të rishikojë dhe të bëjë ndryshime në dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë fushë.

Në vitin 2008 Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit kishte nënshkruar kontratë ekskluzive me kompaninë "EuroLab" për homologimin e automjeteve që regjistrohen për herë të parë në Kosovë, duke e autorizuar kompaninë në fjalë si të vetmen për këtë veprimtari për periudhën 2009-2019.



Punëtorët e Lotarisë së Kosovës të hënën do të protestojnë para qeverisë

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Punëtorët e Lotarisë së Kosovës kanë paralajmëruar protesta për javën e ardhshme (të hënën) para ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për ta kërkuar miratimin e Ligjit për Lotarinë e Kosovës dhe përmbushjen e obligimeve nga ana e Qeverisë si pronare e Lotarisë së Kosovës.

Pas ndalimit të lojërave të fatit sipas ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ku janë përfshirë edhe lojërat e lotarisë, Lotaria e Kosovës e ka ndërprerë veprimtarinë e saj. "Nga ajo kohë e deri më sot nuk është marrë asnjë iniciativë për hartimin e ligjit të veçantë për Lotarinë e Kosovës ashtu siç është premtuar. Punëtorët e Lotarisë së Kosovës janë tejet të

shqetësuar dhe të indinjuar me këtë neglizhencë të institucioneve përkatëse për çka pakënaqësinë e tyre do ta shprehin edhe me anë të protestave", është theksuar në njoftimin e Lotarisë së Kosovës. Sipas këtij njoftimi, protesta e paralajmëruar do të vazhdohet gjatë ditëve të punës deri në përmbushjen e kërkesave të punëtorëve të Lotarisë së Kosovës.



Komuna e Skenderajt nis projektin rrugor Syriganë - Pemishtë

SKENDERAJ, 5 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me drejtoreshën e Urbanizmit, Sanije Ahmeti, dhe me bashkëpunëtorë të tjerë, kanë inspektuar fillimin e punimeve për realizimin e projektit kapital rrugor Syriganë - Pemishtë. Në kuadër të këtij projekti janë 7 069 metra shtrirje asfalti, që përfshihen në segmentet rrugore në fshatrat Syriganë, Pemishtë, Qitak, Leçinë dhe Ternovë. Pas vizitës

në terren, kryetari Jashari ka thënë se si qeverisje lokale janë duke u angazhuar për modernizimin e infrastrukturës rrugore në çdo vendbanim të Skenderajt. "Me stafin tim mbështetës jemi çdo ditë nëpër fshatra, kudo që kanë filluar punimet, për ta parë ecurinë e realizimit të projekteve dhe për të bashkëbiseduar me banorët vendës, në mënyrë që edhe ata të jenë një lloj mbikëqyrësi i projekteve kapitale", ka thënë Jashari.



Pezullohet procesi i dhënies në shfrytëzim të kiosqeve në kryeqytet



PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Kuvendi Komunal i Prishtinës me 43 vota për ka vendosur për pezullimin e procesit të dhënies në shfrytëzim të kiosqeve deri në harmonizimin e kriterëve përbaluese për konkurrentët. Ky vendim është marrë pas një debati që është zhvilluar në mes të asamblistëve të kryeqytetit, të cilët e kanë quajtur joligjor vendimin e kryetarit të Prishtinës, Shpend Ahmeti, për vënien e kriterit për qarkullim në vlerë prej 5 milionë eurosh për aplikuesin.

Në mbledhjen e Kuvendit Komunal kanë marrë pjesë edhe pronarët e kiosqeve të

cilët paraditen e së premtes kanë protestuar kundër vendimit të Komunës së Prishtinës për shpalljen e ankandit publik për kiosqet, i cili, sipas tyre, është diskriminues dhe përmban kriterë të papërbalueshme për ta. Përfaqësuesi i protestuesve, Sadudin Ahmeti, gjatë protestës ka thënë se qarkullimi mujor i tyre është vetëm 2 000 deri në 3 000 euro. Sipas tij, është e pamundur të arrijnë qarkullimin siç e ka kërkuar komuna 5 milionë euro në tre vjetët e fundit. Ahmeti ka thënë me anë të këtij vendimi të komunës rreth 70 punëtorë do të mbesin pa punë.

Filluan punimet në rrugën Bibaj - Driton Islami në Ferizaj

FERIZAJ, 5 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka marrë pjesë në fillimin e punimeve në rrugën Bibaj (Kuçja R6) - Driton Islami (N2) Ferizaj. Ministri Lekaj ka pohuar se është i përkushtuar të investojë në Ferizaj dhe komuna të tjera sepse ato janë baza e zhvillimit të vendit dhe këto projekte mundësojnë lëvizje më të lirë të mallrave dhe njerëzve, duke ndihmuar zhvillim të bizneseve, nëpërmjet lidhjes me autostradë. Ai ka

shtuar se edhe ky projekt i sotëm është dëshmi e vendosmërisë së dhe diakterit që ai drejton që Ferizaj të marrë pamje tjetër sa i përket infrastrukturës rrugore.

Ky projekt është financim i MIT-së me vlerë prej 1 milion e 325 mijë eurosh, ka gjatësi prej 2.2 kilometrash. Në kuadër të saj do të asfaltohen edhe shtatë rrugica të tjera që lidhen me këtë rrugë. Krahas rrugës, do të punohet edhe për kanalizimin përgjatë këtij aksi rrugor.



Filluan punimet e rrugëve në dy lagjet e fshatit Banjë

MALISHEVË, 5 KORRIK (ER) - Të premtën në fillimin e punimeve të rrugëve të reja, në dy lagjet e fshatit Banjë, lagjen Elshani dhe Shurdhaj të Komunës së Malishevës, nga afër punimet i ka inspektuar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha. Rrugët janë në gjatësi prej 670 metrash dhe do të ndikojnë në lidhjet e

lagjeve me rrugën kryesore si dhe do t'i ndihmojnë banorët në qarkullimin më të shpejtë në punët e përditshme. "Ju t'i gëzoni bashkë me fëmijët tuaj këto rrugë që do t'u ndihmojnë për kryerjen e punëve dhe lëvizjes më të sigurt. Këto rrugë krijojnë edhe standarde më të mira për jetë, për zhvillim dhe mirëqenie", ka thënë

Berisha. Ai ka njoftuar se planifikimet komunale në infrastrukturën rrugore për vitin 2019 po realizohen sipas dinamikës së paraparë të projekteve. "Përveç infrastrukturës rrugore, rrugët në shumë fshatra po bëhen edhe me ndriçim publik, i cili do të vazhdojë siç është i planifikuar nga qeveria komunale", ka thënë Berisha.



Fjalim i përmortshëm në varrimin e veprimtarit Gani Sylaj

*E dashur zonja e Ganiut, Hasime Sylaj,
Të dashur familjarë të Ganiut,
Të nderuar miq,
Vëllezër dhe motra,*



Mehmet HAJRIZI

Nga një sëmundje e rëndë pushoi së rrahuri zemra e madhe e veprimtarit të shquar, Gani Sylaj, duke na kthyer ditën e sotme në dhembje e pikëllim dhe ndarje të rëndë. Ajo zemër që rrihte një jetë për Atdheun dhe lirinë e tij, u detyrua padrejtësisht të ndalej, kur i zoti i saj kishte ende shumë punë për të kryer, sidomos në shkrime memoristike e letrare, për t'u lënë trashëgim brezave porositë atdhetare, mesazhin e lirisë.

Si një yll nga qielli i përflakur i Kosovës, befasisht u shua jeta e vëllait tonë të dashur, Gani Sylaj, birit besnik dhe burrit të madh të Kosovës, luftëtarit të paepur dhe kokëunjur të lirisë së popullit të vet, idealistit të përkushtuar deri në vetëmohim, mendjes së ndritur dhe iluministit e emancipuesit të palodhshëm.

I shtrenjti miku dhe bashkëveprimtari im, Gani Sylaj

Ti njëherë u betove, në emër të jetës e të lirisë, në emër të gjakut të derdhur rrëke ndër shekuj, në emër të dinjitetit dhe krenarisë njerëzore, në emër të fëmijëve të kësaj toke të zhurit, në emër të lumturisë e dashurisë për Atdheun e qytetarët e tij; për luftën finale dhe ngadhënjimtare të Kosovës së robëruar.

Ti si Prometheu e shpërndave ndër njerëz zjarrin e urrejtjes ndaj së keqes dhe të dashurisë fisnike e atdhetare, zjarrin e rezistencës dhe të lirisë.

Ti e zgjove shpirtin kryengritës të njerëzve të popullit tënd, ti nga shërbëtori e bëre luftëtarin e vendosur, nga i pashpresi, optimistin, nga i nënshtruar, rebeluesin, nga frikacak, guximtarin... Ti shpërndave ngado moralin e lartë atdhetar, krenarinë e të qenit shqiptar, dinjitetin njerëzor dhe guximin qytetar.

Ti Gani u mbushe shpirtin njerëzve me virtyte e vlera fisnike, me vendosmërinë në rrugën e drejtë të lavdisë. Ti bashkove grushtet kryengritës të të gjitha moshave, potencialin e çlirimit dhe të ardhmërisë.

Ti dije të bëje miq, duke i mbledhur rreth një qëllimi të lartë, dije t'i doje e t'u buzëqeshje ëmbël të tjerëve, duke i bërë shpejt për vete, t'i këshilloje e të kujdeseshe, duke ua dhënë gjithë vlerat që kishe.

Ti Gani Sylaj në lulen e rinisë tënde, sulmove qiejt e mbarsur me retë e zeza të robërisë, sul-

move një perandori të tërë në lulëzim, për të shpëtuar popullin tënd të vogël e të mirë.

Ti i prangosuri i pamposhtur, i tmerroje persekutorët me qëndrimin tënd prej Davidi përballë Goliatit.

Ti miku im nuk u lëkunde kurrë nga ideali i madh atdhetar, sado i lartë që ishte çmimi.

Ti ia dhe jetën, ditë dhe natë, pjesë-pjesë Atdheut tënd që aq shumë e deshe.

Ti Gani Sylaj e dije se një ditë mund të vinte vdekja, por e për-buzje dhe e përcmoje tërë jetën, se nuk ia kishe frikën. Ti me jetën dhe veprimtarinë tënde Gani je bërë pjesë e thesarit të madh kombëtar të vlerave sublimë, prandaj me ty Kosova dhe gjithë kombi ynë janë krenar. Ja përse ne të përcjellim sot me ballin lart në amshim.

Çfarë të flasë më parë për personalitetin tënd miku im i dashur?

Për sistemin e vlerave që përfaqësoje, apo për figurën tënde morale, për virtytet e larta e fisnike që kishe, apo për pasurinë e përvojës tënde të gjatë e të vështirë në Lëvizjen Kombëtare,

për burrërinë, guximin, shpirtin e sakrificës e përballjen me burgun mesjetar, për përkushtimin çlirimtar sa një jetë njeriu, për mijëra faqet e shkrimeve tuaja përmbajtjesore lënë trashëgim, për qëndrimin model të të qenit bashkëshort, prind, vëlla, mik e shok besnik, apo do të hesht sot i nimitur miku im?

Jo nuk do të flas sot, sepse do të shkruhet e do të flitet gjatë për ty, për jetën dhe veprimtarinë tënde të begatë.

Lamtumirë miku im i shtrenjtë, pusho i qetë, sepse ti e di që kauza jote triumfoi, ideali yt do të ngadhënjejë tërësisht dhe fara e mbjellë do të lulëzojë.

Së fundi dua të të them se ti ishe veprimtar i rregullave dhe normave, por ato dhe ligjin e natyrës i theve së fundi, sepse fjalë të përmortshme duhej të mbaje ti për mua dhe jo unë për ty.

Bashkë me dheun e Kosovës tënde të dashur, ty të mbulon lavdia, prandaj mbetesh i pavdekshëm ndër breza, shoku dhe vëllai im i shtrenjtë.

Lavdi jetës dhe veprës së të madhit Gani Sylaj!

Motrat e Shotës, vizitë te varri i saj në Fushë-Krujë



FUSHË-KRUJË / KORRIK - Të enjten (më 5 korrik) ishte 92-vjetori i vdekjes së heroinës Shotë Galica. Për kujtimin dhe nderin e saj, një grup i femrave veprimtare ishin për vizitë te varri në Fushë-Krujë, ndër to edhe Shkurta Dajaku, anëtare e Këshillit Drejtues të PDK-së. Në një postim në "Facebook", Dajaku ka publikuar disa fotografiku shihet edhe deputetja Ganimete Musliu, me përshkrimin: "Vizitë te varri i Shotë Galicës në 92-vjetorin e vdekjes. Shotë Galica është shembulli më

i mirë i thënies se vitet janë vetëm numra, e numrat statistikë që nuk kanë vlerë aq sa të bëmat, gjurmët e të cilave bëhen motiv që përcillet me gjenerata të tëra. Me vetëm 32 vjet jetë, angazhimi, atdhedashuria dhe trimëria e Shotë Galicës, edhe pas 92 vjetëve të vdekjes, mbeten shembull dhe frymëzim i lirisë!"

Shotë Galica, me emrin e vërtetë Qerime, ishte luftëtare e shquar e çetave kryengritëse të Kosovës për çlirimin dhe bashkimin kombëtar të të gjitha viseve

shqiptare. Duke shpërfillur terrorin e armikut dhe ligjet e ashpra të fesë e të Kanunit luftoi heroikisht për 12 vjet me radhë kundër pushtuesve serbë, aus-



trohungarezë dhe bullgarë. Gjatë gjithë kohës ishte përkrah bashkëshortit Azem Galica derisa ra në një çarje rrethimi. Shota, tre vjet më vonë, më 1927, ndërroi jetë në Fushë-Krujë, në mjerim të plotë dhe e shpërfillur

plotësisht nga regjimi i kohës. Janë motrat e Shotë Galicës nga mbarë Kosova që nderojnë kujtimin e saj dhe i freskojnë varrin me lule, aq më shumë që tani janë të lira ta vizitojnë kur të duan. ("Epoka e re")



#WomeninEnergy

Mbi një million dollarë ndahen për 28 bursistet

Përmes programit 'Gratë në Energji', 28 vajza dhe gra kosovare kanë përfituar bursa të plota studimi në Amerikë në fushat e nevojshme për sektorin energjetik të Kosovës. Këto bursiste do të jetojnë dhe studiojnë në qytetin Des Moines dy vitet e ardhshme, duke u fokusuar në studime të shkencës, teknologjisë, makinerisë dhe inxhinierisë.

"Gratë në energji" është implementuar nga Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK), ndërsa është financuar nga agjencioni federal amerikan Korporata e Sfidave të Mileniumit (MCC).

Bursistet kosovare janë përzgjedhur pas një procesi rigoroz të aplikimit ku kanë marrë pjesë 169 kandidatë të cilat janë testuar në anglisht, testim të njohurive mekanike dhe duke kaluar në intervista të monitoruara nga ekipet e ekspertëve amerikanë dhe kosovarë. Lëndët që këto vajza dhe gra do t'i studiojnë janë në harmoni me nevojat e zhvillimit të sektorit energjetik—si teknologjia e turbinave të ajrit, menaxhimi i termocentraleve, ndërtimi i paneleve solare, menaxhimi i ujërave në energji, teknologjia e informacionit, eficaenca energjetike, etj.

Sean Cairncross, drejtori i ri i sapoemëruar i MCC, për këtë program bursash ka deklaruar se "adreson një nga faktorët kyç që po pengojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës—mungesën e grave në tregun e punës, sidomos në fushat si energjia. Fuqizimi i mundësive ekonomike për gratë është prioritet rrënjësor për MCC që synon zvogëlimin e varfërisë nëpërmjet rritjes ekonomike. Programi i bursave 'Gratë në Energji' luan një rol të rëndësishëm të mundësojmë këtë".

Kongresmeni amerikan Eliot Engel, që njëkohësisht është edhe kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme në Kongres, deklaroi: Ky program bursash i MFK dhe MCC është investim i duhur në shkencë,

teknologji dhe fusha të rëndësishme për zhvillim të Kosovës, dhe se gratë fitueseve të bursave do të bëhen lideret e së ardhmes në Kosovë".

Petrit Selimi, drejtori ekzekutiv i MFK, fondacionit që implementon grantet amerikane të MCC, ka thënë të jetë "ndër aktivitetet e para konkrete që po shpërfaqen në publik dhe njëkohësisht ndër më të rëndësishmet sepse investon në arsimimin dhe krijimin e lidershit të grave në sektorët e rëndësishëm ekonomik si energjia."

"Në energji, sot mbi 92% të punësuarve janë burra. Ne synojmë që nëpërmjet programeve të ndryshme, t'a rrisim pjesëmarrjen e grave në këtë sektor." - ka shtuar Selimi.

Programi i bursave "Gratë në Energji" është aktiviteti i dizajnuar dhe implementuar nga Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK), entitetit përgjegjës për implementimin e Programit të Pragut të nënshkruar në mes të SHBA—ve dhe Kosovës më 2017, e që mundëson investime prej 49 milionë dollarësh në projekte të rëndësishme për Kosovën, si sektori i energjisë së ripërtërishme që do të mbështetet nëpërmjet garancioneve bankare, eficaencës energjetike, eficaencës së sistemit të ngrohjes qendrore apo ai transparencës qeveritare nëpërmjet garave sfiduese në Open Data.

Foundacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK)

Ndërtesa Qeveritare (ish Banka e Lubjanës)

Migjeni 21, Kati 9
10000 Prishtinë, Kosovë
millenniumkosovo.org/
womeninenergy



Radari mbi lirinë e shprehjes



Faton ISMAJLI

Policia dhe prokuroria e kanë ndërtuar një standard të ri, të keq, në drejtësinë e çoroditur të shtetit për atë se çka është "liri e shprehjes" dhe se çka është "pengim i personit zyrtar". I kanë arrestuar dy persona pse të tjerëve ua kanë mundësuar të tregojnë vendndodhjen publike të policisë me radar. Me këtë veprim është shkelur me dy këmbët liria e shprehjes. Liria për të dhënë dhe për të marrë informacione i papenguar. Gabimin e organit të ndjekjes dhe akuzës duhet ta ndreqin gjyqtarët, nëse lënda shkon në gjykim.

Mos u çudisni nëse nesër në mëngjes e shihni me pranga në duar gazetaren Edita Doli. Sipas kutit të policisë, Edita prej vitesh e shkel ligjin pse i informon qytetarët për vendndodhjen e radarëve.

Pak a shumë, njësoj u ka ndodhur edhe dy qytetarëve të Kosovës, të cilët janë arrestuar të martën vetëm pse kanë krijuar një grup në "Viber" dhe ua kanë mundësuar të tjerëve të shpërndajnë informacione për vendndodhjen e policëve, të cilët kanë dalë në rrugë për t'i

dënuar shoferët që vozisin shpejt.

Dallimi i gazetares me dy personat e tjerë është vetëm te kanali i komunikimit: Edita komunikon në radio, e dy të arrestuarit e kanë përdorur "Viber"-in për t'ua mundësuar të tjerëve të njoftojnë se ku ndodhen "specat".

Dikush duhet t'ia sqarojë policisë dhe prokurorisë se Kushtetuta e këtij vendi e ka rregulluar lirinë e shprehjes dhe e ka paraparë kur duhet të kufizohet ajo. Rrjedhimisht, i ka përcaktuar rrethanat se kur mund të shpërndahet informacioni dhe kur ndalohej një veprimtari e tillë. "Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush", shkruhet në Nenin 41, Pikën 1.

Pra, sipas Kushtetutës, secili person në këtë tokë dardane ka të drejtë të shpërndajë dhe të marrë informacione i papenguar nga askush. Secili ka të drejtë edhe të shpërndajë dhe të marrë mesazhe, po ashtu, i papenguar.

Dy të arrestuarit e kanë bërë pikërisht atë që e thotë Kushtetuta e Republikës. Kanë shpërndarë informacione përmes një mediumi.

Akti më i lartë juridik i shtetit i ka paraparë edhe rastet kur kufizohet liria e shprehjes. "Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një

gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare", thuhet në Kushtetutë.

Pra, liria e shprehjes, liria për të treguar informacione, për të marrë informacione kufizohet, nëse një informacion i tillë nxit dhe provokon dhunë dhe armiqësi mbi baza racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Grupi në "Viber" nuk ka nxitur asnjë provokim dhe as dhunë. As armiqësi në baza etnike e fetare. Krejt çka kanë bërë ata dy persona është se kanë treguar se ku ndodhen policët e Kosovës.

Nuk tregojnë për ndonjë veprim të fshehtë të policisë, por për daljen e tyre publike në rrugë për ta kontrolluar shpejtësinë e veturave.

Në anën tjetër, Policia e Kosovës ka njoftuar se dy personat janë arrestuar pasi kanë penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrave, bazuar në Kodin Penal. Nuk kanë specifikuar se cilat nene i kanë shkelur, pasi lënda ka shkuar në procedurë të rregullt dhe rrjedhimisht dy personat e arrestuar janë lënë të lirë të mbrohen.

Në Kodin Penal, në Nenin 401, Pikën 2 të Kodit Penal të Kosovës sqarohet se në çfarë situatash konsiderohet se një veprim "e pengon dikë në kryerjen e detyrës zyrtare". "Kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me

veprim të përbashkët e pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet", thuhet në Kodin Penal.

Në situatën konkrete, prokurori duhet të argumentojë se cilin polic e kanë penguar dy të arrestuarit. Duhet të argumentohet se pse e kanë penguar. Qysh e kanë penguar? Me çfarë veprimi? A është pengim i personit zyrtar, nëse dikujt i tregon se dikush ndodhet në rrugë? Krejt këto pyetje kërkojnë përgjigje bazuar së pari në Kushtetutë, e pastaj edhe në ligjet e zbatueshme.

Edhe diçka. Pra, dy të arrestuarit s'e kanë njoftuar askënd, por ua kanë mundësuar të tjerëve ta njoftojnë njëri-tjetrin.

Në fakt, grupi i shoferëve në "Viber" s'ka bërë kurrfarë pengimi në kryerjen e detyrave zyrtare të policisë. I ka ndihmuar të ketë më pak punë. Ka ndihmuar të jenë më të kujdesshëm shoferët dhe, rrjedhimisht, i detyron policët të dalin më shumë nëpër rrugë, t'i ndërrojnë vendet. Pra, i vetëdijeson policët se duhet të kontrollohen rrugët.

Kontrollet me radar nuk janë operacione të fshehta dhe bëhen, pra, në vende publike. Bile ka edhe programe të navigimit nëpër vende të ndryshme të BE-së që tregojnë se në cilat vende ka kontrollues

të shpejtësisë si formë e vetëdijesimit. Ky është edhe një argument më shumë se s'ka kurrfarë pengimi në kryerjen e detyrës zyrtare pse dikush tregon se policia ndodhet në rrugë. Pra, njoftimi se ka radar në një rrugë është njësoj sikurse shenjat e komunikacionit që njoftojnë për kufizimin e shpejtësisë.

Para së gjithash, Policia s'e ka dhe s'është të ketë prioritet dënimin e shoferëve, por vetëdijesimin e tyre. Pavarësisht këtyre komunikimeve nëpër grupe, bazuar në shifrat e publikuara, çdo ditë në Kosovë dënohen mesatarisht një mijë shoferë. Pra, me fakte mund të konstatohet se s'është ulur numri i gjobave në trafik për shkak të këtyre njoftimeve.

Meqë lënda ende s'ka marrë epilog, por vetëm sa ka nisur procedura penale e ndjekjes së dy personave vetëm pse kanë shpërndarë informacion publik për vendndodhjen publike të policisë, duhet ta shohim vendimin e gjykatës. Nëse lënda përnjëmend përfundon me aktakuzë ndaj këtyre dy personave, atëherë i mbetet organit që vendos në emër të popullit ta përmirësojë gabimin e organit të akuzës. Të mos e dënojë dikë pse i ka përdorur mediet për të shpërndarë informacione në mënyrë të papenguar, siç saktësohet në Kushtetutë.

Nëse ndodh e kundërta, duhet të blejmë pako me cigare dhe t'ia dërgojmë gazetares së emisionit "Radar" në Burgun e Lipjanit.

Thaçi jep "Urdhrin e Lirisë" për veprimtarin Brahim Zeka



PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Për kontributin e dhënë për lirinë e Kosovës, pas vdekjes, presidenti Hashim Thaçi ka deko-

ruar me "Urdhrin e Lirisë" veprimtarin Brahim Zeka. "Për kontributin e dhënë për lirinë e Kosovës, pas vdekjes,

me Urdhrin e Lirisë e dekorova veprimtarin Brahim Zeka. Në emër të familjes këtë dekoratë e pranuan deputeti

Milaim Zeka, e përndjekura politike Habibe Zeka, e cila ishte edhe pjesëtare e lëvizjes së ilegale kombëtare, si dhe

ish i burgosuri politik Fatmir Krasniqi", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Stoltenberg: Asnjë përparim me Rusinë për traktatin për armët

Sekretari i përgjithshëm Jens Stoltenbergu tha se NATO-ja dhe Rusia nuk arritën të shënojnë përparim për ta shpëtuar Traktatin e Armëve Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi gjatë bisedimeve në selinë e aleancës të zhvilluara të premtën

BRUKSEL, 5 KORRIK - NATO-ja dhe Rusia nuk arritën të shënojnë përparim për ta shpëtuar Traktatin e Armëve Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi gjatë bisedimeve në selinë e aleancës të zhvilluara të premtën. Lajmi është bërë me dije nga sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, nënshkroi dy ditë më parë ligjin që pezullon pjesëmarrjen e vendit në traktatin në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë, të nënshkruar në vitin 1987. Shtetet e Bashkuara pritet të tërhiqen nga marrëveshja më 2 gusht pasi kanë akuzuar Rusinë se ka dislokuar një sistem raketash që bie ndesh me paktin. Moskë thotë se i është përmba-

jtur plotësisht traktatit të negociuar nga presidenti i ShBA-së Ronald Reagan dhe udhëheqësi sovjetik Mikhail Gorbacov, traktat që eliminonte arsenalin me raketa të mesme të dy fuqive më të mëdha bërthamore në botë. "Nuk kemi parë ndonjë shenjë për ndryshim", u tha Stoltenbergu gazetarëve pas një takimi të këshillit NATO-Rusi, që u mbajt me dyer të mbyllura. Stoltenbergu tha se shanset për një zgjidhje "po shuheshin çdo ditë", por ai shtoi se Aleanca nuk kishte hequr dorë nga përpjekja për të bindur Moskën për të shkatërruar raketat tokësore SSC-8, të cilat mund të përshkruajnë një largësi përtej kufirit që parashikon traktati. Prishja e marrëveshjes, zhvillimi më i fundit në listën e



tensioneve në rritje të lindje-perëndim, krijon shqetësime serioze. Ekspertët dhe zyrtarët

perëndimorë thonë se raketat me rreze të mesme veprimi do t'i krijojnë mundësinë Rusinë

që të niste një sulm bërthamor në Evropë brenda një kohe të shkurtër.

Marina britanike konfiskon një anije iraniane

LONDËR, 5 KORRIK - Marina Mbretërore britanike konfiskoi në Gjibraltari një anije iraniane që dyshohet se po transportonte naftë të papërpunuar në Siri, duke shkelur sanksionet e Bashkimit Evropian. Uashingtoni nuk e ka konfirmuar ende lajmin, por këshilltari për Sigurinë Kombëtare John Bolton tha se ShBA-ja dhe aleatët e saj do të vazhdojnë të ndalojnë Sirinë dhe Iranin të "përfitojnë nga tregtia e paligjshme". Autoritetet e Gjibraltarit, me ndihmën e Marinës Mbretërore Britanike, e kapën anijen "Grace 1" të enjten herët në mëngjes në ujërat e detit Mesdhe, katër kilometra larg Gjibraltarit. Irani thirri në një takim



ambasadorin britanik në Teheran për t'i shprehur "kundërshtimin e tij të fortë ndaj konfiskimit të paligjshëm dhe të

papranueshëm" të anijes, sikurse u shpreh ai. Ministria britanike e Mbrojtjes publikoi imazhe të një helikopteri

mbi anije, duke thënë se operacioni ishte kryer me kërkesën e autoriteteve të Gjibraltarit. Por ministri i Jashtëm i Spanjës,

Josep Borrell, tha se beson se manovra dramatike ishte kryer me kërkesën e Shteteve të Bashkuara. Spanja e ka kritikuar konfiskimin, duke thënë se praktikisht anija ishte në ujëra spanjolle. Irani mbështet luftën e presidentit sirian Bashar al-Asad kundër forcave të shumta rebele që po përpiqen ta largojnë atë nga pushteti. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara kanë vendosur sanksione ndaj Sirisë. Vitin e kaluar presidenti Donald Trump vendosi sanksione ndaj eksporteve iraniane të naftës pas largimit të Shteteve të Bashkuara nga marrëveshja bërthamore me Teheranin e arritur në vitin 2015.

Turqia pranon dërgesën e parë të raketave ruse

ANKARA, 5 KORRIK - Dërgesa e parë e sistemit raketor rus pritet të arrijë në Turqi, gjatë javës së ardhshme, raporton Reuters duke cituar televizionin privat turk, Haberturk. Uashingtoni e ka paralajmëruar Turqinë, se do të përballet me sanksione, nëse e instalon sistemin rus. Ankaraja mund të përjashtohet edhe nga projekti i furnizimit me aeroplanët amerikan F-35, nëse e përmbush kontratën me

rusët. ShBA-ja thotë se sistemi rus, përbën rrezik për aeroplanët e saj ushtarak. Mediumi turk, gjithashtu raportoi, se një ekip i teknikëve rus do ta mbikëqyrë instalimin e sistemit. Edhe aleatët e tjerë të NATO-s kanë shprehur brengën lidhur me këtë ndërmarrje të Turqisë. "Pavarësisht prej sanksioneve që mund të pasojnë, pavarësisht prej mesazheve nga Amerika, ne

e kemi blerë sistemin S-400", tha, më 24 qershor, ministri i Jashtëm turk Mevlut Cavusoglu. Në muajin maj ndihmësekretarja amerikane e Mbrojtjes, Kathryn Wheelbarger, tha se blerja e sistemit të raketave S-400 nga ana e Turqisë do të kishte një efekt "shkatërrues" për raportet e saj me aleatët e tjerë të NATO-s si dhe pjesëmarrjen e saj në programin e furnizimit me aeroplanë luftarakë të ShBA-së, F-35.



Zendaya në Paris me diamant 32 karatë



Zendaya, me plot kuptimin e fjalës, ka shkëlqyer në Javën e Modës në Paris. Aktorja 22-vjeçare ka marrë pjesë në lansimin e parfumit Lancome Idole, ku ajo vetë është fytyra reklamuese e tij e mbushur me bizhuteri Chopar me

hiç më pak se 32 karatë. Zendaya kishte vënë vathë të mëdhenj nga ari i bardhë në formë rrethore me diamant 25.78 karatë derisa kishte edhe dy unaza me gurë diamante, njëra 1.30 karat dhe tjetra mbi 5 karatë.

Sharon Stone blen 20 palë syze të reja



Sharon Stone duket se e ka shpërblyer veten me syze të reja pasi është parë se ka dalë për të blerë syze në Beverly Hills. Aktorja 61-vjeçare e ka marrë procesin e përzgjedhjes së

tyre shumë seriozisht duke analizuar nga afër shumën prej syzeve që i kanë pëlqyer. Ylli i "Basic Instinct" ka provuar disa lloje të syzeve me forma dhe ngjyra të ndryshme.



Kim Kardashianit i shtohen milionat

Kim Kardashian West ka fituar 2.7 milionë dollarë dëmshpërblim pas akuzave që i bëri një kompanie mode amerikane për vjedhjen e imazhit. Ajo e ka çuar në gjyq

firmën "Missguided USA", duke treguar se përdorni emrin e saj për t'i shitur rrobat. Kështu Kimi ia doli ta fitonte gjyqin dhe të shtonte në llogarinë e vet 2.7 milion dollarë.

Britney Spears rrëfen dietën sekrete për fansat



Këngëtarja "Piece of Me" ka thënë nëpërmjet një postimi në "Instagram" se kishte humbur katër kilogramë, duke zbuluar edhe sekretet e dietës. Britney Spears ka pohuar se suksesin e arriti duke ngrënë

perime dhe fruta të caktuara për ta mbajtur peshën nën kontroll. "Kisha sy të lodhur, stres, astma dhe dhimbje koke, por kjo tabelë më ka ndihmuar shumë me problemet dhe peshën time", ka treguar Britney.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Ademi dënohet me nëntë muaj burgim efektiv, Komiteti Ekzekutiv i jep mbështetje

Agim Ademi është dënuar me nëntë muaj burgim efektiv nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Pas këtij vendimi ka reaguar Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës, i cili beson në pafajësinë e Ademit dhe njëherësh i jep mbështetje të plotë



PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, është dënuar me nëntë muaj burgim efektiv nga Gjykata Themelore në Prishtinë pasi është shpallur fajtor për një rast nga dy veprat penale me të cilat ngarkohej. Në aktgjykimin e shpallur të premten Ademi është dënuar me nëntë muaj burgim efektiv për veprën penale të detyrimit në tentativë, ndërsa është shpallur aktgjykim refuzues për ushtrim të ndikimit, shkak se kjo veprë penale është parashkruar, raporton "Betimi për Drejtësi".

Ndërsa i akuzuari tjetër në këtë rast, Muharrem Rama, është dënuar me një vit burgim për veprën penale të detyrimit në tentativë. Aktakuza ndaj Ramës dhe Ademit është ngritur më 14 janar 2014 në bashkëpunim të Prokurorisë Themelore të EULEX-it me Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Sipas pretendimeve të prokurorit të EULEX-it, Maarten Groothuizen dhe prokurorit Ilaz Beqiri në pikën e parë të aktakuzës, të pandehurit Ademi dhe Rama gjatë periudhës kohore 12 korrik - 12 shtator 2012 me qëllim të përfitimit material e kishin kërcënuar dhe sulmuar viktimën Dritëro Kadollin, duke e detyruar të njëjtin

të bëjë veprime në dëm të pasurisë së tij, respektivisht të bëjnë përfitim të padrejtë në shumën prej 30 000.00 eurosh, apo një veturë të tipit "BMW X5", e cila veturë më pas pretendohet t'i dorëzohej kryesuesit të Asamblesë Komonale të Prishtinës, Sami Hamiti, duke kryer veprën penale detyrimi në bashkëkryerje.

Ndërkaq, në pikën e dytë të aktakuzës të pandehurit Ademi dhe Rama akuzohen për ushtrim të ndikimit në bashkëkryerje. Sipas aktakuzës, dy të akuzuarit kishin kërkuar nga i dëmtuari Kadolli premtimin e përfitimit të pa drejtë, respektivisht shumën prej 30 000.00 euro apo veturën e tipit "BMW X5", duke kërkuar në lidhje me ushtrimin e ndikimit jo të duhur të tyre në vendimmarrjen e një personi zyrtar që në këtë rast është kryesuesi i Asamblesë Komonale në Prishtinë, Sami Hamiti, që ta ndryshojë statusin e një ngastre toke nga "zonë e gjelbëruar" në "zonë ndërtimore". Pas këtij vendimi ka reaguar Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës, i cili i ka dhënë mbështetje të plotë kryetarit Agim Ademi. "Kryetari Ademi para anëtarëve të KE-së ka thënë se komunikimin e vendimit e konsideron të padrejtë dhe të pabazuar, sepse nuk

e ndjen veten fajtor.

Kryetari Ademi do të vazhdojë t'i ndjekë deri në fund të gjitha procedurat ligjore-ankimore, të cilat janë të parapara me ligjet e vendit, jo për ta mbrojtur postin, por për ta dëshmuar pafajësinë e tij dhe për ta mbrojtur kredibilitetin e institucionit. Gjithsesi, kryetari Ademi do t'i respektojë të gjitha vendimet e institucioneve çfarëdo qofshin ato në përfundim. Kryetari presidenti Ademi falënderon të gjithë aktorët e futbollit për përkrahjen dhe premtën se do të vazhdojë njësojë me punë dhe përkushtim në drejtimin e FFK-së dhe sukseseve të reja, ashtu siç ia garanton Kushtetuta e vendit dhe aktet normative të FFK-së", thuhet në reagimin e Komitetit Ekzekutiv. "Njëkohësisht KE i FFK-së i jep mbështetje të fuqishme presidentit Agim Ademi që të vazhdojmë së bashku me trendin e sukseseve nën drejtimin e tij dhe fton opinionin e gjerë dhe të gjithë dashamirët e futbollit që këtë lajm ta marrin me qetësi dhe maturi. KE i FFK-së konsideron se kjo është një tjetër sfidë e radhës, e cila besojmë se do të tejkalohet dhe do të na bëjë edhe më të fortë për realizimin e vizionit dhe objektivave të FFK-së", thuhet në njoftimin e Komitetit Ekzekutiv.

SHKURT

Kosova në Universiadën Botërore Verore

Federata e Sportit Universitar e Kosovës nga data 7-14 korrik do të marrë pjesë në Universiadën Botërore Verore që po mbahet nga 3-14 korrik në Napoli të Italisë. Kosova do të marrë pjesë me garesit e saj për herë të parë që prej pranimin në FISU më 2017. Megjithatë, vështirësitë për shkak të buxhetit të limituar, FSUNK-ja do të përfaqësohet në këtë garë të nivelit botëror me katër pjesëmarrës, dy anëtarë delegacioni, kryetarin Musa Selimi dhe zëvendëskryetarin Abedin Bahtiri si dhe me dy atletë: Astrit Kryeziu (800m) dhe Rita Hajdini (400m dhe 800m). Nga sportistët e Kosovës priten paraqitje të mirë me synimin për të shënuar rezultatet personale më të mira. Federata i ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, duke përfshirë pajisjen me viza dhe detajet e udhëtimit.

Dukagjini zyrtarizon largimin e 'Dugit'

Dugagjin Gashi është larguar ditë më parë nga Dukagjini i Klinës dhe ka vendosur që karrierën futbollistike ta vazhdojë në skuadrën e Besës së Pejës. Mirëpo skuadra nga Klina vetëm të premtën e ka bërë publik lajmin për largimin e Gashit, derisa bëjnë me dije se dëshira e tyre ishte që mesfushori të ishte pjesë e Dukagjinit edhe në IPKO Superligë. "Dugin e falënderuam për kontributin e dhënë gjatë një viti sa ishte pjesë e jona dhe i dëshiroam shumë sukses, shëndet dhe çdo të mirë", thuhet në njoftimin e KF Dukagjini.

Bekaj ndahet me Prishtinën

Një ndër portierët më të mirë shqiptarë që ka pasur Prishtina, Visar Bekaj, i ka mbyllur të gjitha negociatat e transferimit në futbollin ndërkombëtar. "I jam mirënjohës presidentit Ejupi që ka punuar shumë të më gjejë angazhim atje ku pretendoja. U jam mirënjohës të gjithë trajnerëve, stafit dhe lojtarëve me të cilët kam punuar si dhe tifozët 'Plisat'. Më mbetet peng dhe ëndërr titulli i kampionit me Prishtinën, por besoj shumë se vetëm me trajner Josën, i cili është trajneri më i mirë me të cilin kam punuar, do t'ia arrijnë qëllimit dhe ta rikthejnë titullin në sezonin që po vjen. Ky nuk është mendimi vetëm imi, por i të gjithë shokëve të skuadrës", ka thënë Bekaj, i cili me Prishtinën ka zhvilluar 133 ndeshje.

Humbje e turpshme nga vashat e Kosovës

Basketbollistet e Kosovës U-18 (F) kanë zhvilluar ndeshjen e parë në Kampionatin Evropian, Divizioni B, që po zhvillohet në Maqedoninë Veriore. Vashat e Kosovës kanë pësuar nga superfuqia evropiane e basketbollit, Sllovenia, me rezultat 12:97. Kjo ishte ndeshja e parë e Kosovës, kurse të shtunën do të luajnë ndaj Estonisë. Vashat e Kosovës, pavarësisht se janë më të reja në moshë se kundërshtarët dhe më me pak përvojë e gjatësi, kanë zhvilluar një ndeshje të mirë, derisa tani po përqendrohen për ndeshjen e ardhshme. Synimi i Kosovës nga fillimi ishte një fitore në grup, duke i përqendruar forcat te ndeshja me Norvegjinë, që zhvillohet të martën. Dy përfaqësueset e para në grupe do të kualifikohen në çerekfinale, vendi i tretë dhe i katërt do të luajnë për pozitën 9-16, kurse vendi i pestë dhe i gjashtë në grupe do të luftojnë për pozitën 17-23.

Muriqi: Do ta respektoj kontratën me Rizesporin

PRISHTINË, 5 KORRIK - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, është i vendosur për ta respektuar kontratën me skuadrën e Rizesporit. Sulmuesi shtatllartë është lidhur me një kalim të Galatasaray

apo Fenerbaçes, por duket se ai do të vazhdojë të djersitë fanellën e skuadrës aktuale edhe në edicionin 2019/2020. "Kam pasur një bisedë telefonike me presidentin Hasan Kartalin dhe i tregova mendimin tim

rreth të ardhmes. Duke qenë se ka mosmarrëveshje për transferimin, dua të bëj me dije se do ta respektoj kontratën time me Rizesporin deri në fund. Ky është vendimi im përfundimtar", ka thënë Muriqi.



Sponsorizimi sjell më shumë medalje për sportistët dhe çmime për artistët

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë në debatin me temën "Çfarë përfitimesh sjell zbatimi i Ligjit për Sponsorizime në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë" organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe Instituti i Kosovës për Sport. Në këtë debat ministri Gashi, ka thënë se kjo është një nismë e qëlluar sepse me anë të kësaj informohen kompanitë dhe të gjithë ata që janë të interesuar për të filluar një fazë të re të mbështetjes për sportin sepse ky ligj parasheh sponsorizim jo vetëm për sport, por edhe për kulturë dhe rini. "Ne kemi nxjerrë të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë qenë të obliguara sipas ligjit, siç ka qenë Rregullorja për Kriteret dhe Vërtetimin e Sponsorizimeve dhe, po ashtu, kemi themeluar një komision i cili vërteton sponsorizimet, një mekanizëm që është krijuar në kuadër të kësaj rregulloreje dhe që ka një kontroll të jashtëzakonshëm në procedurat e sponsorizimit", ka thënë ministri Gashi, duke shtuar se: "Themelimi i komisionit i heq të gjitha dilemat për mundësinë e keqpërdorimeve apo shpëlarjes së parasë". Gjithashtu, ministri Gashi njoftoi se deri tani janë dërguar 38 vërtetime për sponsorizim. "Tani jemi në një hap ku të gjithë do të jemi të



koordinuar për ta filluar zbatimin e këtij ligji dhe të gjitha veprimet që i kemi marrë deri tash nuk do kenë efekt nëse ky ligj nuk zbatohet", ka shtuar ai.

Ministri Gashi foli edhe për financimin e sportistëve nga ana e ministrisë duke thënë se 50% e buxhetit të Ministrisë i është dedikuar sportit dhe duke pasur parasysh edhe rezultatet e mëdha të sportistëve, sporti mbetet edhe më tutje prioritet. "Nuk është rastësi që vitin e kaluar kemi pasur rreth 100 medalje, por me këtë amendamentim, me zbatimin e Ligjit për Sponsorizime, në Kosovë do të kemi

më shumë medalje dhe çmime edhe në rrafshin e kulturës, por sporti mbetet sektori kryesor i promovimit të vendit dhe dhënies së një imazhi ndryshe në arenën ndërkombëtare", përfundoi ministri Gashi.

Ndërkaq, kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka deklaruar: "Kompanitë tona e kanë mundësinë ideale që të përkrahin një kauzë që është kontribut i zhvillimit të këtij vendi. Këto kompani sjellin shumë taksa. Këto do të jenë edhe kompanitë më meritore për ta sjellë përpara fuqizimin e sportit".

Hamiltoni, piloti më i paguar në Formula 1



"Business Book GP 2019", një revistë e pavarur e garave të Formulës 1, ka publikuar pagat e 20 pilotëve të Formulës 1 që marrin pjesë në Botërorin 2019. Piloti më i paguar është britaniku i Mercedesit, Lewis Hamilton, me 42 milionë euro. Ajo që bie në sy është

se mes tij dhe dy pilotëve më pak të paguar ka një diferencë jashtëzakonisht të madhe, 40 milionë eurosh. Në vendin e dytë renditet Sebastian Vettel me Ferrari. Me 35 milionë euro. Surpriza është vendi i tretë në podium, Daniel Ricciardo me Renault, me 20 milionë.

LISTA E PILOTËVE

1. Lewis Hamilton	42 milionë euro
2. Sebastian Vettel	35
3. Daniel Ricciardo	20
4. Max Verstappen	12
5. Nico Hulkenberg	8
6. Valtteri Bottas	8
7. Kimi Raikkonen	6
8. Sergio Perez	4
9. Carlos Sainz	4
10. Charles Leclerc	3
11. Romain Grosjean	2
12. Kevin Magnussen	2
13. Lance Stroll	1.5
14. Pierre Gasly	1.5
15. Robert Kubica	1
16. Alexander Albon	750
17. Daniil Kvyat	750
18. Lando Norris	700
19. George Russell	500
20. Antonio Giovinazzi	500

SHKURT

Real, 70 milionë dhe dy lojtarë për Pogban

Real Madridi e dëshiron me çdo kusht mesfushorin e Manchester Unitedit, Paul Pogba. Real ka ofruar 70 milionë euro për francezin dhe dy vjet e skuadrës: Toni Kross e Gareth Bale. Mesfushori i "Djajve të Kuq" është shumë i kërkuar nga "Los Blancos" dhe Juventus. Real po mundohet ta transferojë mesfushorin në "Santiago Bernabeu" dhe është gati t'i sakrifikojë dy vjet e skuadrës për të bërë këtë transferim.

Neymari merr "bekimin" e Messit për rikthim te Barça

Neymari dhe Barcelona janë gjithnjë e më afër. Sipas raportimeve të fundit në mediet spanjolle, të dyja palët kanë arritur marrëveshjen mes tyre. Edhe PSG-ja ka pranuar shitjen e tij duke i besuar liderin e ekipit francezit Mbappe. Mediet në Spanjë shkruajnë se Neymari ka marrë edhe "bekimin" e Messit për t'u rikthyer. PSG-ja kërkon një shumë të mirë për shitjen e tij, diçka që Barcelona do ta ketë të lehtë ta realizojë, pasi ka përfituar plot 300 milionë euro nga shitjet e lojtarëve. Në disa media shkruhet se marrëveshja do të finalizohet me 140 milionë euro. Barcelona ka dhe një avantazh tjetër. Në marrëveshje mund ta fusë brazilianin tjetër, Coutinho. Coutinho nuk është më në planet e Barcelonës dhe ai është kërkuar nga PSG-ja. Kjo mund të ndikojë në marrëveshjen e tyre.

Napoli, ofertë të 'çmendur' për Icardin



E ardhmja e Mauro Icardit është shndërruar në një telenovelë që nuk ka fund. Një lajm i bujshëm është duke qarkulluar në mediet italiane. Sipas "Corriere dello Sport", Icardi është pranë marrëveshjes me Napolin teksa presidenti Aurelio De Laurentis është i gatshëm t'i ofrojë një rrogë prej 10 milionë eurosh në sezon. Kujtojmë se kjo është shifra që sulmuesi argjentinas iu ka kërkuar drejtuesve të Interit, por këta të fundit nuk kanë qenë dakord. Kështu Napoli duket gati për goditjen e bujshme në merkato, teksa pret krahëhapur sulmuesin argjentinas.

Marcelo preferon largimin nga Real, e dëshiron Arsenalin

Skuadra e Arsenalit është në garë për ta nënshkruar me mbrojtësin e majtë të Real Madridit, Marcelon. 31-vjeçari brazilian iu ka thënë drejtuesve të "Los Blancos" se ai dëshiron të largohet nga klubi pasi pozita e tij ka filluar të lëkundet. Marcelo ka kaluar 13 vjet në "Bernabeu", por mund të jetë zgjedhja e dytë në sezonin e ardhshëm pasi Zinedine Zidane transferoi për 47 milionë funte Ferland Mendyn nga Lyoni. Sipas gazetës spanjolle "Sport", Arsenali, Juventus, Paris Saint-Germain dhe Milani janë të gjithë të interesuar në yllin e Real Madridit.

Cocu, trajner i Derbyt

Phillip Cocu nis një përvojë të re si trajner në Angli pas përvojës së shkurtër te Fenerbahçe në Turqi. Tekniku 48-vjeçar holandez ka marrë vendin e lënë bosh nga Frank Lampard (u emërua trajner i Chelsea) te skuadra e Derby Countyt në Angli. Ish-mesfushori holandez ka spikatur te PSV-ja, Barcelona dhe përfaqësuesja holandeze, derisa ka firmosur kontratë katërvjeçare me klubin e Championshipit, niveli i dytë më i lartë i futbollit anglez. Cocu do të ketë si objektivi të ngjisë Derby Countyt në Premierë Ligë që në sezonin e parë në krye të kësaj skuadre.

Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA KANADEZE NË FOTO 1	LLOJ KARROÇË E HAPUR, E TËRHEQUR PREJ KUAJSH	PJESË E SIPËRME E TRUPIT TË NJERIUT (shq.)	PËREMËR VETOR	FSHATI KU NDOHET AEROPORTI I TIRANËS	SHKOJ, ECI (bised.)	PËRZIEJ, TRAZOJ	ZANORE	EPOKA ERE	DIÇKA E FITUAR ME PUNË E ME DJERSË (krah.)	OHAJO, LUIZIANA	MALLKOVA												
PLUHUR I BARDHË KRISTALOR, SHUMË I ËMBËL									GREMINË, HUMNERË PËRÇUES I NJË QËLLIMI A PIKËSYNIMI															
POEZIA E DASHURISË								LLOJ KAFSHE SHTËPIAKE (pashq.)																
QË SHPREHET ME PAK FJALË E NË MËNYRË TË PRERË								QË ËSHTË I KUQ I NDEZUR DY BASHKËTINGËLLORE			SHKRONJA XVIII NATRIUM													
INDIGENOUS BUSINESS AUSTRALIA				ZANORE ERION (perkdh.)		QYTET I VJETËR NË KOSOVË TITULL OTOMAN																		
NAIM ABAZI			PIKTOR I YNI SHUMË, TEJ MASE (turq.)																					GRUP I VOGËL USHTARËSH
BASHKËTING.		TRAJNERI ITALIAN SAKI NDALIMI						VARIOLË KIDS ARTISTIC REVUE			BASHKËTING. FËMIJË I VOGËL; KALAMA													
SHTET NË AZI (pashq.)					RRIP LLASTIKU, PËR TË MBAJTUR FUNDET QË ËSHTË ME TINGUJ TË ÇRREGULLUAR					DY ZANORE ALBANOLOGIA DURHAM								AUSTRALIAN VACCINATION NETWORK	NOTË MUZIKORE	I SISTEMA-TIZUAR	KUFI, LIMIT	EMRI I PASHAIT TË JANINËS		
TEATËR NË PRISHTINË				ZANORE FUTBOLLISTI SAMUEL ... (INTER)		"INDIA"	HERO I YNI																	
SATANI, DJALLI							KËNGËTARJA ROZANA INTONACION											FEUDAL QË I NËNSHTROHEJ MBRETTIT TRAJNERI SPANJOLL LUIS						
EPOKA ERE	SHTET NË EVROPË (pashq.) ZOG I PULËS SË DETIT (sh.shq.)							VIGAN, KOLOS VEGËL E METALTË ME KOKË TË HARKUAR											DY (turq.) FUTBOLLISTI ... COSTA (VALENCIA)					
PËRZIERJE E ÇIMENTOS ME ZHAVORR E ME UJË						I FËLLIQR, I PASTËR; I BASHKËTING.												DY BASHKËTINGËLLORE KOHA QË KUR ERRET DERI NË AGIM				U TAKOVA	MOSHË E RE	
IDRIZ SEFERI			NATIONAL INSTITUTE IMUNOLOGY	PJESË E BRENDSHME E KËMISHËS TË BUKURIT						USHQYER FOSHJËN LLOJ GJELLE ME PATATE														
VULGAR, I NDRË						MOR, HEJ (pashq.) LLOJ KROKODILI (shq.)			BASHKËTING. LLOJ HELMI LUFTE															
ZANORE		"IRLANDA" BASHKËTING.					BANORI I HERSHËM I NJË KRAHINE ZANORE																	
LLOJ LËNDE SHPËRTHYSE (shq.)								FUSHËBETEJA BISKOTË E GATUAR ME ARRA (shq.)						URANIUM, TITAN NJERINGRËNËS										
																								
	KUZHINË POPULLORE PRANË XHAMISË (sh.pashq.)																		KONINKLIJK ATHENEUM ETTERBEEK KUJDESTARI (Jur.)	KUNDREJT I BARDHË				
	BASHKËTING.										DIREK I KULMIT	PIKËNISJA INDIANA, ARIZONA												
	KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO 2												UNITED NATIONS REPERI ... DOGG (shqip.)				KLUB FUTBOLLI HOLANDEZ .. ALKMAR							
	SHENJA NDERKOMBËTARE PËR KAMION								MUNDËSIA, SHANSI RESHAT ARBANA									SHKRONJË GREKE	INDONEZIA LORIK (shk.)					
																				RENS ISTVUD				
FUTBOLLISTI DANIELE (MILAN) KËSTI BANKAR PËR KTHIMIN E KREDISË																								
AKTORJA E VJETËR ... RINA								ENË E HOLLË GJAKU (shq.)																

ZGJIDHJA E FJALËKRITIT: SAKARINA, HON, EROTIKA, KALË, LAKONIK, ALL, M, BA, A, ARTANA, NA, ESAT VALLA, D, ARIGO, G, MI, TIR, RASTI, I, BONERA, NOBEL, RATA, MURATOR, ITA, KAPILARI.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Batusha Group" Sh.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810820888 dhe ka caktuar likuidatorin Shaban Ismajli (tel. 044-194-334) për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Batusha Group" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810820888 ujedno imenovao Likvidatora Shaban Ismajli (tel.044-194-334) o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Batusha Group" L.L.C. has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810820888, the company has appointed a likuidator Shaban Ismajli (tel.044-194-334) who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Pro Construcion" Sh.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810143280 dhe ka caktuar likuidatorin Shaban Ismajli (tel. 044-194-334) për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Pro Construcion" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810143280 ujedno imenovao Likvidatora Shaban Ismajli (tel.044-194-334) o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Pro Construcion" L.L.C. has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810143280, the company has appointed a likuidator Shaban Ismajli (tel.044-194-334) who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Batusha" Sh.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 8100824385 dhe ka caktuar likuidatorin Shaban Ismajli (tel. 044-194-334) për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Batusha" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 8100824385 ujedno imenovao Likvidatora Shaban Ismajli (tel.044-194-334) o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Batusha" L.L.C. has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 8100824385, the company has appointed a likuidator Shaban Ismajli (tel.044-194-334) who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Apollon Gjota B.I" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 70747960 - Prishtinë.

"Sport Caffè" Sh.p.k shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 70902729.

Elvira Zeqiri shpallë të pavlefshme dokumentet e Shkollës së Mesme "Eqrem Qabej", Prishtinë.

Fitore Selmani shpallë të pavlefshme dokumentet Shkollës së Mesme "28 Nëntori", Prishtinë.

Berat Haxhija shpallë të pavlefshme diplomën bachelor të Kolegjit AAB, Prishtinë me nr. 1025/16.

Qendrim Avdyli shpall pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Anton Çetta" Skenderaj, drejtimi informatikë.

Arijanita Osmanaj shpall te pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "Anton Çetta" Skenderaj drejtimi Dogan dhe shpedicion si dhe Dëftesat e kl. X, XI dhe XII.

Ermira Duga shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Leke Dugagjini" Prizren.

Geront Ademaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves
Hospital and University Clinical Service of Kosova
Universiteteske Bolnicke Klinicke Sluzbe Kosova
Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës – Univerziteti Stomatološki Klinički Centar
Kosova – University Dentistry Clinical Center of Kosovo



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitive të nenit 4. dhe neni 5 të Udhëzimit (MPMS) Nr. 07/2017 Administrativ për Rregullimin e Procedurave të Konkursit për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, neni 15 dhe 21 të Statutit, Rregullores mbi Organizimin, Sistematizimin e vendeve të punës dhe Aprovimit të kërkesës nr 214, nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK –së, Qendra Klinike Stomatologjike Universitare shpall :

K o n k u r s **Për plotësimin e vendit të lira të punës**

Titulli i vendit të punës: Mjek Specialist në Klinikën e Triazhimit (2 pozita))
005/2019-QKSUK;
Dt: 05.07.2019

Orari i punës: 40 orë në javë
Koeficienti: 8.40 / H-20
Nëpunësi mbikëqyrës: Shefi i klinikës
Kohëzgjatja e Kontratës: Me kohë të pacaktuar

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

Ofron shërbime stomatologjike të cilat i përkasin kësaj lëmie.
Ofrimi efektiv i shërbimeve me kualitet të lartë.
Sigurimi i kujdesit shëndetësor stomatologjik për të gjithë popullatën pavarësisht nga gjinia apo përkatësia etnike.
Ndihmon dhe koordinon bashkëpunimin efektiv ndërmjet shërbimeve stomatologjike.
Ndihmon dhe zhvillon sistemin informativë stomatologjik në kuadër të shërbimeve stomatologjike.
Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrorit të mbikëqyrësit.

Kualifikimi: Diploma Universitare-Dega e Stomatologjisë, specialist në njërin nga lëmit e stomatologjisë, i/e licencuar nga MSH.

Përvoja: 1 vjet punë profesionale në sektorin e Stomatologjisë si specialist nga lëmia përkatëse ose dëshmia nga edukimi i vazhdueshëm profesional.

Aftësitë: Themelimi i marrëdhënieve të mira ndër-personale dhe mbajtja e kontakteve me personat vendim marrës në klinik.
Njohja e gjuhëve zyrtare, në përdorim.
Aftësitë e mira të komunikimit.
Gatishmëria për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe me pak mbikëqyrje.
Njohja e mire e punës me kompjuter (Microsoft Word dhe Excel).

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë mjekët specialist, të gjitha lëmit të stomatologjisë, Shtetas të Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit:

Konkursi për të gjithë kandidatët e interesuar, është i hapur 15 ditë kalendrike nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e personelit të QKSUK-së. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës.

Kontaktet:

Mund të kontaktoni në numrin e telefonit ; 038 512 525. apo në E-mali adresën qksukfadilkrasniqi@hotmail.com

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të pranohen.
Kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e konkursit, do të ftohën për intervistim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves
Hospital and University Clinical Service of Kosova
Universiteteske Bolnicke Klinicke Sluzbe Kosova
Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës – Univerziteti Stomatološki Klinički Centar
Kosova – University Dentistry Clinical Center of Kosovo



Na osnovu člana 8 Zakona o radu br. 03 / L-212, odredbe člana 4. i člana 5. Uputstva (MRSZ) br. 07/2017 Upravni postupak za regulisanje javnih ugovora za utvrđivanje odnosa sa javnošću, čl. 15. i 21. Statuta, Pravilnik o organizaciji, sistematizaciji radnih mjesta i odobrenje br. 214, od strane Generalnog Direktora UBKSK, Univerziteti Klinički Centar za Stomatologiju objavljuje:

K o n k u r s **Za dopunu slobodni radni mjesta**

Radni naslov za pozicije: Lekar specijalista za kliniku trijaže (2 pozicije)
Br. Ref. 005 / 2019- USKCK Dt: 05.07.2019

Vreme: 40 sati nedeljno
Koeficijent: 8:40 / H-20
Nadzorni službenik: Šef klinike
Trajanje ugovora: Sa neograničeno

Glavne obaveze i odgovornosti:

Pružat stomatološke usluge koji pripadaju ovoj oblasti.
Efektivna pružanje kvalitetnih usluga.
Osiguranje zdravstvene stomatološke zaštite za cjelokupno stanovništvo bez obzira na pol ili etničku pripadnost.
Asistira i koordinira efikasnu saradnju između stomatoloških usluga.
Pomaže i razvija informacioni sistem stomatološke usluge.
Obavlja i druge poslove po nalogu supervizora.

Kvalifikacije:

Univerzitetaska Diploma-grana stomatologije, specijalista u jednoj od oblasti stomatologije, licencirana od strane MZ.

Iskustvo: 1 godina profesionalnog rada u oblasti stomatologije kao specijalista u toj oblasti ili dokaz kontinuiranog profesionalnog obrazovanja.

Sposobnost: Uspostavljanje dobrih odnosa i održavaju međuljudske kontakte sa licima iz kliničke odlučivanja.

Znanje službenih jezika u upotrebi.
Dobre sposobnosti komunikacije.
Spremnost da rade samostalno i sa malo nadzora.
Dobro poznavanje računara (Microsoft Word i Ekcel)

Uslovi konkursa: Pravo na prijavu imaju lekari specijalisti, sva područja stomatologije, su svi građani Republike Kosova odraslih u koji imaju punu pravnu sposobnost, oni su završili odgovarajuće obrazovanje i profesionalne veštine da obavljaju svoje dužnosti.

Procedura konkurencije: Konkurs za dve zainteresovane kandidate, je otvoren 15 dana kalendarskih dana objavljivanja u medijima.

Podnošenje prijave: Prijave se mogu dobiti i podneti u kancelariju osoblja USKCK . Zahtev mora biti jasno navedeno radno mesto i referentni broj

Kontakt: Možete kontaktirati na broj telefona; 038 512 525. E-mount ili adresa qksukfadilkrasniqi@hotmail.com

Prijave primljene nakon isteka roka prijava konkurencije i nepotpune neće biti prihvaćeni.

Kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa će biti pozvani na intervju.

Sot me 06.07.2019 u bënë 12 vite pa babën dhe gjyshin tonë



QAZIM SALLAUKA

(27.05.1952 - 06.07.2007)

Nga vdekja e pa pritur ti vajte në amshim pa na thënë lamtumiren e fundit. Do të mbetesh gjithmonë i çmuar i respektuar dhe i paharruar për ne dhe për të gjithë që të njohën.

Të përkujtojnë: Bashkëshortja Gjylfidani, djali Liridoni, reja Teuta, nipat që shumë i deshe Blendoni, Edisoni e Gentriri nga fshati Topliqan Therandë



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

